



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 371 Akti

Nr. 486 Vendimi
Tiranë, më 15.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përberë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Xhensila Pine	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Harvatin, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 9.12.2021, ora 14:00 në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arqile Basho**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Z. Arqile Basho, është subjekt rivlerësimi, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, z. Arqile Basho, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Olsi Komici, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine (relatore).
3. Komisioni administroi nga institucionet ndihmëse të procesit, raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të

Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues, komisionerin Olsi Komici dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Arqile Basho, bazuar në kriterin e rivlerësimit të pasurisë dhe vlerësimin e figurës; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë dhe rivlerësimit të figurës referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitareve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 22.11.2021, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për kriterin e pasurisë dhe të figurës, për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

I. SEANCA DËGJIMORE

7. Në datën 9.12.2021, ora 14:00, u zhvillua seanca dëgjimore, në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

7.1 Në përfundim të seancës dëgjimore trupi gjykues ftoi subjektin, të shprehte qëndrimin e tij përfundimtar për procesin e rivlerësimit. Subjekti në fjalën e tij përfundimtare kërkoi: (i) çeljen e hetimit administrativ për vlerësimin e kriterit profesional; (ii) riçelje të hetimit administrativ për dy kriteret e tjera, të pasurisë dhe të figurës; si dhe (iii) konfirmimin në detyrë. Në vijim trupi gjykues duke marrë në konsideratë edhe sugjerimin e vëzhguesit ndërkombëtar¹, tërhiqet për vendim, data e të cilit do t'i njoftohej subjektit në adresën e tij elektronike, si dhe do të shpallej në faqen zyrtare të Komisionit.

7.2 Seanca për shpalljen e vendimit të trupit gjykues u zhvillua në datën 15.12.2021, ora 9:15.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/ HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

A. Vlerësimi i pasurisë

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*

¹Vendimi i GjEDNj-së, Xh. kundër Shqipërisë, 9 shkurt 2021, paragrafi 326...: [Gjykata vëren se e drejta për një proces të drejtë ligjor siç garantohet nga neni 6/1 i Konventës përfshin të drejtën e palëve në proceset gjyqësore për të paraqitur çdo parashtrim që ata e konsiderojnë të rëndësishëm për çështjen e tyre. Qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta teorike ose imagjinare, por të drejta praktike dhe efektive, e drejtë kjo që mund të shihet të jetë efektive vetëm nëse parashtrimet “dëgjohen” me të vërtetë, domethënë, konsiderohen siç duhet nga gjykatat vendëse. Me fjalë të tjera, efekti i nenit 6 është, ndër të tjera, për ta detyruar “gjykatën” për të kryer shqyrtimin e duhur të parashtrimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykuar vlerësimin e saj nëse ato janë apo jo të rëndësishme..].

- ka mosdeklarime të aseteve dhe vlerës së godinës në emër të vajzës;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të plotë dhe të gjithanshëm, janë kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt dhe personave të lidhur me të, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me gjetjet e Komisionit bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017, të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore, për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore (DPV) dhe atë të rivlerësimit kalimtar (deklarata *Vetting*), të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shkresore të administruara në këtë dosje dhe të dhënave të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nga ku ka rezultuar si vijon:

1. Banesë me sip. 120 m² dhe truall me sip. 300 m², në Njësinë Administrative “O.”, Gjirokastër

1.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar banesë privatë me sipërfaqe e ndërtuar 120 m² dhe truall me sip. 300 m² e regjistruar në ZVRPP-në Gjirokastër, subjekti ka depozituar si dokumenti provues: vërtetim nr. ekstra prot., datë 25.1.2017, të ZVRPP-së Gjirokastër, si dhe listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive z. k. ***, fshati “A.P.”, Gjirokastër. Sipas këtij vërtetimi në emrin e shtetasit Arqile Basho figuron pasuria e paluajtshme nr. ***, e llojit truall me sip. 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 120 m².

1.2 Në lidhje me burimin e të ardhurave subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... *banesa është ndërtuar nga prindërit e mi në vitin 1956, ka qenë në pronësi të tyre deri në vdekjen e tyre. Nuk janë kryer procedurat e trashëgimisë ligjore dhe të kalimit të banesës² me trashëgimi. Përfitur pa shpërblim. Vlera e banesës është e papërcaktuar, është ndërtuar në vitin 1956, është rikonstruktuar në vitet 1987 dhe 1994. Nuk ka një vlerë tregu për orientim*”.

1.3 Në deklarimin për herë të parë në datën 18.3.2004, subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në seksionin e pasurive të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to.

1.4 Komisioni, bazuar në neni 83 të Kodit Civil, në të cilin parashikohet mënyra e kalimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme, vëren se subjekti nuk ka depozituar dokumentacionin ligjor për kalimin e pronës nga prindërit në emrin e tij. Kalimi i pronësisë mbi sendet e paluajtshme dhe i të drejtave reale mbi të behet me akt noterial dhe me pas regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

1.5 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se:

i) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* mënyrën e përfitimit të të drejtave reale mbi të, si dhe nuk ka provuar kohën dhe shumën e investimit të kryer prej prindërve të tij apo dhe prej tij në këtë pasuri;

²Së bashku me deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar edhe certifikatën e vdekjes së babait, i cili ka ndërruar jetë në datën 25.10.1988, ndërsa nëna në datën 24.5.2007.

ii) në deklaratimet periodike, nga deklaratën për herë të parë, nuk e ka deklaruar këtë pasuri, duke mos zbatuar dispozitat e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.6 Subjekti, në prapësimet e tij, ndër të tjera, shprehet se: “*Fillimi i deklaratimeve vjetore ka nisur në vitin 2003 dhe nuk kemi qenë të orientuar më elementët e deklarinimit dhe formulari i deklarinimit nuk përmbante rubrika të posaçme për të deklaruar pasuritë që dispononim në atë kohë. Kjo pasuri nuk është krijuar në kohën e periudhës së deklarinimit dhe as nga ana ime. Banesa është ndërtuar 2 (dy) vjet para lindjes sime, nga prindërit e mi, në vitin 1956, nuk kam shtuar sipërfaqe ndërtimore, vetëm e kam mirëmbajtur dhe përmirësuar kushtet e banimit. Mënyra e përfitimit të pasurisë së mësipërme rrjedh nga regjistrimi i kësaj pasurie si pasojë e dërgimit të listës së pronësisë sipas Formularit *** për regjistrimin e trojeve në fshat, bazuar në VKM-në nr. 432, datë 14.8.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonat urbane³ të fshatit”.*

*Nga ana e Komunës O. është bërë verifikimi i banesave dhe trojeve duke evidentuar emrat e pronarëve dhe me pas plotësimi i formularit *** për trojet dhe është përcjellë në ZVRPP-në Gjirokastër. Në këtë listë është edhe emri im si banor i fshatit ‘A.P.’, më pas azhurnimi përkatës i bërë nga ZVRPP-ja, është bërë regjistrimi i pasurisë me nr. ***, e llojit truall dhe ndërtesë më sipërfaqe 300 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 120 m², z. k. ***, fshati ‘A.P.’. Regjistrimi i pronës është bërë me ligj dhe jo duke ndjekur procedurat e zakonshme të regjistrimit të pasurive të paluajtshme nga shtetasit që kanë në pronësi pasuri të tilla. Sa i përket kohës dhe shumës së investimit të kryer prej prindërve dhe prej meje, nuk ka një vlerë tregu për t’u orientuar në zonën në fjalë. Mosdeklarimi për herë të parë i pasurisë së mësipërme ka qenë një pakujdesi dhe gabim njerëzor të cilin e kam korrigjuar në deklarinimet e mëvonshme. Duke qenë së prona rrjedh nga prindërit e mi, nuk ekziston asnjë detyrim ligjor që të bëj kalimin e saj nëpërmjet procesit të dëshmisë së trashëgimisë. Dy vëllezërit dhe motra ime nuk kanë asnjë pretendim në këtë pasuri. Rrjedhimisht, konkluzioni i ILDKPKI-së se deklarimi nuk është i saktë dhe se nuk ekziston dokumentacioni ligjor për justifikimin e kësaj pronësie, nuk qëndron”⁴.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.7 Trupi gjykues, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, në shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të barrës së provës, si dhe në deklarinimet e subjektit në seancë, arsyeton se prapësimet e subjektit nuk gjejnë mbështetje në dispozitat e Kodit Civil mbi trashëgiminë. Vetë subjekti pohon se kjo ndërtesë është ndërtuar nga prindërit e tij në vitin 1956 dhe me vërtetimin e faktit të vdekjes së prindërve, pasuria në emër të tyre i nënshtrohet trashëgimisë testamentare ose ligjore⁵. Banesa është ndërtuar me punën dhe kontributin e prindërve të subjektit, në vitin 1956 dhe, rrjedhimisht, këta të dy janë bashkëpronarë të saj. Sipas rregullimit të ligjit të kohës, por edhe sot, për bashkëpronësinë

³VKM-ja nr. 432, datë 14.8.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonat urbane të fshatit”, në të cilën parashikohet se: “1. Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme në zonën urbane të fshatit, komuna ose bashkia i kërkon pronarit dokumente të pronësisë sipas kritereve të përcaktuara në ligj, për pronësinë e ndërtesave dhe të trojeve në këtë zonë. 2. Madhësia e sipërfaqes së truallit në pronësi të pronarit të ndërtesës që ka kryer ndërtimin mbetet ajo që është miratuar sipas dispozitave ligjore ekzistuese deri në daljen e ligjit nr. 7633, datë 7.4.1993, “Për urbanistikën”. 3. Dokumentacioni i azhurnimit për pasuritë e paluajtshme të zonës urbane të fshatit sipas formularit që i bashkëngjitet këtij vendimi, vihet në dispozicion të komunës, miratohet nga ky organ dhe bëhet regjistrimi i kësaj pasurie. 4. Ngarkohen organet e pushtetit lokal (komuna dhe bashkia) dhe Njësia e Menaxhimit të Projektit të SRPP për zbatimin e këtij vendimi”.

⁴Prapësime të subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

⁵Babai i subjektit ka ndërruar jetë në datën 25.10.1988, ndërsa nëna e subjektit në datën 24.5.2007.

nuk mund të konsiderohen automatikisht bashkëpronarë në një pronë të krijuar persona që janë pjesëtarë të familjes, që nuk kanë dhënë asnjë kontribut. Regjistrimi i shtëpive të ndërtuara në zonat urbane të fshatrave, rrjedhimisht edhe shtëpia e banimit e prindërve të subjektit duhet të regjistrohej në emrin e tyre ose trashëgimtarëve ligjore, bazuar në kriteret e kërkuara në VKM-së nr. 432, datë 14.08.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”.

1.8 Në ligjin nr. 6340, datë 26.06.1981, “Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”: (a) në nenin 77 (pronësia vetjake), përcaktohet se: “Janë pronë vetjake të ardhurat nga puna dhe nga burime të tjera të ligjshme, shtëpia e banimit dhe sende të tjera, që shërbejnë për plotësimin e nevojave materiale e kulturore vetjake e familjare”. Në nenet 86, 87 (bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve) përcaktohet se:

a) Neni 86: “Sendet, depozitat në arkat e kursimit dhe çdo gjë tjetër e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës janë në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve”.

1.9 Sa më sipër, trupi gjykues arsyeton se prona në momentin kur është regjistruar nga komuna nuk ka qenë e subjektit por e prindërve (kuqtojmë se nëna e subjektit jetonte në vitin 1995). Regjistrimi i pronës në emër të subjektit, duke anashkaluar dispozitat e Kodit Civil mbi trashëgiminë, ka sjellë si pasojë mohimin e pjesëve takuese të trashëgimtarëve të tjerë ligjore. Pretendimi i subjektit se vëllezërit dhe motra nuk kanë pretendime mbi pronësinë e shtëpisë së ndërtuar prej prindërve të tyre nuk është i mbështetur në prova. Mjetet ligjore⁶ për heqjen dore nga trashëgimia janë të përcaktuara nga Kodi Civil në momentin e çeljes së dëshmisë së trashëgimisë së trashëgimlënësit.

1.10 Subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor sa ka qenë vlera e investimeve, ndër vite, mbi këtë pasuri. Nuk paraqiti asnjë provë për të vërtetuar parametrat e kësaj pasurie në kohën e sotme.

1.11 Ligji nr. 9049/2003, neni 4, sanksionon se subjekteve deklarues detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri me 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si vijon: (a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to; (b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publike; (c) ...etj.

1.12 Komisioni, në analizë të fakteve dhe rrethanave në lidhje me mosdeklarimin në deklaratën e interesave private për herë të parë në datën 18.3.2004 dhe të banesës private 120 m² sip. e ndërtuar dhe truall me sip. 300 m², konstatoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë për kriterin e pasurisë, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016.

2. Tokë bujqësore, me sip. 15.680 m², nga e cila rreth 10.000 m² pemëtoare në Njësinë Administrative “O.”, Gjirokastër

2.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar si dokumenti provues vërtetim nr. extra, datë 25.1.2017, të ZVRPP-së Gjirokastër, e cila vërteton se në emër të subjektit figuron pasuria nr. *** e llojit vresht, pasuria nr. *** e llojit pemëtoare, pasuria nr. *** e llojit pemëtoare, pasuria nr. *** e llojit pemëtoare, pasuria nr. *** e llojit arë, pasuria nr. *** e llojit arë, pasuria nr. *** e llojit arë, pasuria nr. *** e llojit arë. Dy aktet e marrjes së tokës në pronësi.

⁶Neni 333 i Kodit Civil parashikon se: “Heqja dorë nga trashëgimia duhet të bëhet me deklaratë të shkruar, që regjistrohet te noteri i njësisë vendore ku është çelur trashëgimia, ose me deklaratë noteriale të redaktuar nga noteri. Heqja dorë mund të bëhet edhe me anë të një përfaqësuesi të pajisur me prokurë të posaçme. Pas regjistrimit të heqjes dorë nga trashëgimia, noteri kryesisht lëshon një dëshmi të re trashëgimie, ku pasqyrohet ndryshimi në rrethin e trashëgimtarëve, si dhe pjesët e tyre takuese, të cilën ia dërgon personit që ka kërkuar lëshimin e dëshmisë fillestare të trashëgimisë”.

2.2 Në deklarimin për herë të parë në datën 18.3.2004, subjekti në seksionin e pasurive të paluajtshme ka deklaruar: tokë arë gjithësej 17 dynym – nga këto 10 dynym pemë frutore. Pjesa takues:1/6. Të ndodhura në Komuna O., fshati “A. P.”.

Në lidhje me burimin e krijimi, subjekti i ka deklaruar të përfituar nga ligji nr. 7501, “Për tokën”. Nuk ka një vlerë tregu për llogaritjen e vlerës së tokës në atë zonë në bashkëpronësi të familjes bujqësore.

2.3 Në bazë të informacionit nga ZVRPP-ja Gjirokastër⁷, konfirmohet se në emër të shtetasit Arqile Basho figurojnë pasuri të regjistruara në bazë të AMTP-së me nr. *** akti, në emër të kryefamiljarit Arqile Basho, si vijon: (i) pasuria nr.***, vol. ***, f.***, z. k.***, vresht me sip. 700 m², sipas AMTP-së dhe 620 m² sipas LN; (ii) pasuria nr.***, vol. ***, f.***, z. k.***, pemëtore me sip. 2.350 m², sipas AMTP dhe 3.200 m² sipas LN ; (iii) pasuria nr.***, vol. ***, f.***, z. k.***, pemëtore me sip. 1.000 m², sipas AMTP dhe 1.050 m² sipas LN; (iv) pasuria nr.***, vol. ***, f.***, z. k.***, pemëtore me sip. 800 m², sipas AMTP dhe 820 m² sipas LN; (v) pasuria nr.***, vol. ***, f.***, z. k.***, arë me sip. 900 m², sipas AMTP dhe 1.070 m² sipas LN; (vi) pasuria nr.***, vol. ***, f.***, z. k.***, arë me sip. 4.000 m², sipas AMTP dhe 4.035 m² sipas LN; (vii) pasuria nr.***, vol. ***, f.***, z. k.***, arë me sip. 1.850 m², sipas AMTP dhe 2.550 m² sipas LN; (viii) pasuria nr.***, vol. ***, f.***, z. k.***, pemëtore me sip. 2.100 m², sipas AMTP dhe 2.340 m² sipas LN.

2.4 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se:

i) subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues burimin e krijimit për tokë bujqësore, e ndarë në disa parcela, me sip. të përgjithshme 15.680 m², nga e cila rreth 10.000 m² pemëtore në prodhim, për sa nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues pjesëtimin/dhurimin/heqjen dorë nga kjo sipërfaqe prej prindërve në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar;

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.5 Subjekti, në prapësimet e tij, sqaron se: “*Në asnjë rast unë nuk kam deklaruar se toka bujqësore është në pronësinë time individuale, kam deklaruar gjithmonë se toka bujqësore është në pronësi të familjes bujqësore. Ajo ka qenë tokë bujqësore në administrim të ish-Ndërmarrjes Bujqësore ‘O.’, fshati ‘A. P.’ dhe kaloi në pronësi të ‘familjes bujqësore’, si e tillë duke u llogaritur me numrin e anëtarëve të familjes sime prej 6 pjesëtarë, fakt që vërtetohet nga certifikatat familjare të dorëzuara. Fakti i ekzistencës së 1 (një) ha të mbjellë pemëtore, kryesisht lajthi të buta, është vërtetuar me dy vërtetime të lëshuara nga komuna “O.” dhe së fundmi nga njësia administrative “O.”. Mënyra e përfitimit të pasurive të mësipërme rrjedh nga dispozitat e ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, ‘Për tokën’, i ndryshuar, si dhe VKM- së nr. 255, datë 2.8.1991, ‘Për kriteret e ndarjes, së tokës bujqësore’, të ndryshuar, VKM-së nr. 452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjes shtetërore”, të ndryshuar. Regjistrimi i kësaj pronësie në ZVRPP-në Gjirokastër nuk është bërë nga ana ime por nga shteti me azhornimin e zonës dhe (në dijeninë time) me fonde të dhëna nga USAID. Në lidhje me konstatimin e bërë nga ana e Komisionit se nuk është provuar më dokumentacion ligjor provues pjesëtimi, dhurimi apo heqja dorë nga kjo sipërfaqe prej pjesëtareve të tjerë të familjes, parashatroj se kjo është një pasuri e familjes bujqësore ku unë jam në cilësinë e kryefamiljarit, fakt ky që provohet nga kartela e pasurisë ku në seksioni C është shënimi ‘F’(pasuri familjare) dhe jo ‘I’ (pasuri individuale). Në konkluzion toka bujqësore është pronësi e familjes jo në pronësisë time personale. Termi i familjes bujqësore si strukturë e aktivitetit ekonomik gjen mbështetje në dispozitat e kodit*

⁷Pjesë e dosjes Vetting nga ILDKPKI-ja, e-mail, datë 17.12.2018.

civil nenet 222 e vijues. Nga këto rregullime të ligjit, vlerësohet se largimi i ndonjë anëtari të 'Familjes bujqësore' nga anëtarësia e familjes bujqësore, nuk shoqërohet me detyrimin për të marrë në mënyrë të detyrueshme pjesën e vet. Në kushtet kur anëtarësia e një familje bujqësore përbehet nga persona që lidhen midis tyre më së shumti nga familjarë (neni 223) marrëdhënia ngelet si marrëdhënie njerëzore. Është në vullnetin (dhe jo detyrimin) e një anëtari të familjes bujqësore që kur shkëputet nga familja, të kërkojë ose jo pjesën takuese të tokës bujqësore. Sa i takon vazhata të mia ato të cilat janë shkëputur nga familja dhe nuk e kanë kërkuar pjesën e tokës së vet. Nëse do ta kërkojnë do të bëhet pjesëtimi dhe ato do marrin pjesën takuese. Ndërsa djali vazhdon të jetë anëtar i familjes bujqësore dhe vazhdon të kontribuojë në punët e familjes bujqësore. Në konkluzion dokumentacioni i kësaj pasurie është i plotë dhe i ligjshme për të justifikuar pronësinë mbi tokën bujqësore dhe të ardhurat nga puna e familjes bujqësore”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

2.6 Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim provat në lidhje me këtë pasuri, deklaratimet e subjektit në deklarata vjetore, shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, vlerësoi se subjekti ka pasaktësi në deklaram në lidhje me këtë pasuri.

2.7 Në deklaratën për herë të parë subjekti deklaroi 17 dynym tokë nga këto 10 dynym pemëtoare, ndërsa në deklaratën *Vetting* deklaroi 15.680 m². Në prapësimet e tij, subjekti përveç konceptit të familjes bujqësore nuk shpjegoi arsyet e mospërputhjes në lidhje me sipërfaqen e tokës bujqësore të përfutur nga ligji nr. 7501/1991.

2.8 Trupi gjykues, bazuar në dokumentacionin e disponuar, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit⁸, bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore paraqitet si bashkëpronësi në tërësi dhe për sa kohë nuk është bërë pjesëtimi sipas nenit 207 të Kodit Civil, ndaj saj zbatohen rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të Kodit Civil për kryerjen e veprimeve juridike në tërësi apo dhe disponimit mbi to në veçanti. Bashkëpronësia në tërësi e familjes bujqësore, për sa kohë nuk është pjesëtuar sipas rregullave të nenit 207 të Kodit Civil, secili prej tyre tërheq të drejta dhe detyrime ndaj asaj pasurie.

2.9 Sa më sipër, subjekti nuk paraqiti ndonjë provë në lidhje me pjesëtimin, dhurimin apo heqjen dorë nga kjo sipërfaqe e familjareve të tij në përputhje me parashikimet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 7501, si dhe dispozitat e Kodit Civil mbi bashkëpronësinë dhe pjesëtimin e sendit në bashkëpronësi.

2.10 Në këto rrethana faktike, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të paplotë për kriterin e pasurisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, paragrafët 1 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Komisioni këtë pasaktësi, nëse do ishte e vetme në deklaramin e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se nuk do të sillte automatikisht shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

3. Autoveturë, tip “BMV X1”, vit prodhimi 2010, blerë në vitin 2013

3.1 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se kjo autoveturë në pronësi familjare, përdoret nga subjekti deklarues, regjistruar në emër të shtetasit L. B. (i biri i subjektit deklarues), blerë në prill 2013, në vlerë 16.000 euro dhe si burim janë deklaruar “*kursimet familjare ndër vite*”.

3.2 Në DPV-në e vitit 2013, në ndryshim të interesave pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar, autoveturë në pronësi familjare në shumën 16.000 euro,

⁸Vendimi nr. 32/2019, i Kolegjit të Posacëm të Apelimit.

blerë dhe regjistruar në emër të shtetasit L. B., me burim nga kursime familjare (kontratë datë 18.4.2013).

3.3 Në bazë të të dhënave nga DPSHTRR-ja⁹, me kontratën e shitblerjes së automjetit nr.***, datë 18.4.2013, shtetasi L. B. (djali i subjektit të rivlerësimit) ka blerë nga shtetasi S. M., autoveturën tip “BMV X1”, vit prodhimi 2010, me targa ***, në shumën 15.000 euro, duke deklaruar se janë likuiduar totalisht mes tyre, si dhe blerësi ka marrë në dorëzim automjetin. Ky automjet është zhdoganuar me *** në datën 18.4.2013 dhe janë shlyer detyrimet doganore në shumën 404.852 lekë (draft me rivlerësimi i doganës Tiranë, pasi vlera e blerjes e deklaruar në doganë ka qenë 250.000 lekë, vlerësimi në doganë 2.024.265 lekë). Ky automjet është regjistruar me targa ***, në datën 24.4.2013. Nuk ka të dhëna për personin që ka paguar shpenzimet e zhdoganimit të kësaj autoveture.

3.4 Sa më sipër, duket se ka mospërputhje në lidhje me çmimin e blerjes së kësaj autoveture, pasi referuar kontratës së shitblerjes, çmimi është 15.000 euro, ndërsa subjekti si në DPV-në e vitit 2013 ashtu edhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar shumën 16.000 euro.

3.5 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3¹⁰, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“Çmimi i dakordësuar për automjetin me shitësin ka qenë 15.000 euro. Në kontratë është evidentuar se ‘Për dokumentacionin e automjetit mban personalisht përgjegjësi ligjore shitësi’. Kjo nënkupton se shitësi me shitjen e automjetit, mban përgjegjësi për dokumentacionin e plotë të automjetit, një ndër të cilët është edhe pagimi i detyrimeve doganore me futjen e automjetit nga ana e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në kushtet kur është diskutuar pagesa e detyrimit doganor, djali ka renë dakord me shitësin që të paguajë një kontribut shtesë në shumën 1.000 euro. Në këto rrethana vlera e pjesës tjetër të zhdoganimit është paguar nga shitësi dhe veprimet e kryerjes së pagesës, në dijeninë time, janë kryer nga të dy së bashku për të përfunduar sa më shpejt veprimet e shitjes.*

Në konkluzion, unë kam shpenzuar për blerjen e automjetit të përdorur të markës ‘BMV’, tip X1, shumën prej 16.000 euro dhe për këtë shkak nga ana ime është deklaruar në këtë shumë”.

3.6 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar koston faktike të blerjes së autoveturës tip “BMV X1”, përse çmimi i blerjes në kontratë nuk përputhet me atë të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, si dhe për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit sa duket se shpenzimet e zhdoganimit janë paguar nga djali i subjektit të rivlerësimit¹¹.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

3.7 Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“...konstatimi i Komisionit më duket objektiv, pavarësisht se e vërteta është ajo që unë kam deklaruar para jush dhe që unë jam në kushtet e kur nuk kam mundur të siguroj dokumentacionin e duhur për këtë...”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

3.8 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet në seancat dëgjimore të zhvilluara me

⁹Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2020.

¹⁰Përgjigje e pyetjes nr. 8.

¹¹Në analizë nga Komisioni është vlerësuar të pasqyrohet shuma 15.000 euro sipas kontratës bashkë me shpenzimet e zhdoganimit në vlerën 404.852 lekë.

subjektin e rivlerësimit, vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë shumën e shpenzuar për blerjen e kësaj autoveture, si dhe të kundërtën e konstatimit të Komisionit se shpenzimet e zhdoganimit janë paguar nga djali i subjektit të rivlerësimit.

Analizë e burimit të të ardhurave të deklaruar për krijimin e kësaj pasurie

3.9 Subjekti në deklaratimet e tij, si burim të ardhurash për blerjen e kësaj pasurie ka deklaruar kursimet familjare ndër vite.

3.10 Në lidhje me këtë burim të deklaruar, Komisioni shqyrtoi deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, për periudhën 2003 – 2012¹², duke analizuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortes) për krijimin e kursimeve *cash* në banesë të deklaruar.

3.11 Nga Komisioni në vlerësim të mosdeklarimit në DPV-të përkatëse, për periudhën 2003 – 2012, të pakësimit të gjendjeve *cash* për blerjen ose krijimin e ndonjë pasurie, shuma e kursimeve *cash* të mbledhura deri në datën 31.12.2012, referuar deklarimeve periodike do të rezultonte në vlerën 3.400.000 lekë.

3.12 Për sa i përket kursimeve në shumën 900.000 lekë, të deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën për herë të parë me burim kontratën me shoqërinë “****”, referuar deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar¹³ nga Komisioni paraprakisht u vlerësua se burimi i deklaruar nuk ka qenë i dokumentuar, për këtë edhe gjendet *cash* të deklaruar me krijim nga ky burim nuk mund të merren në analizë si burim për krijim të pasurive të tjera në vijim.

3.13 Gjithashtu, nga analiza paraprake e treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, për sa i përket kursimeve të deklaruar si shtesë gjendje *cash* në vitet 2011 dhe 2012, rezultojnë me balancë negative fondesh (përkatësisht në shumat 481.894 lekë dhe 1.121.684 lekë), si rrjedhim duket se subjekti nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme për krijimin plotësisht të kursimeve të deklaruar në *cash* në këto vite. Pra, mundësia për kursim në dukje për këto vite nuk ka qenë në vlerën 3.400.000 lekë, por në vlerën 896.422 lekë [3.400.000 lekë - (900.000 lekë+481.894 lekë+1.121.684 lekë)], shumë e cila është pasqyruar në analizën paraprake të treguesve financiarë për këtë pasuri.

3.14 Referuar dokumentacionit të disponuar, si dhe deklarimeve subjektit të rivlerësimit, nga Komisioni u krye një analizë paraprake e treguesve financiarë, për periudhën 1.1.2013 – 18.4.2013, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur për blerjen e pasurisë autoveturë tip “BMW X1”, në shumën 15.000 euro, kryerjen e shpenzimeve të zhdoganimit në vlerë 404.852 lekë, si dhe shpenzimet e deklaruar dhe të evidentuara për këtë periudhë.

3.15 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, sa duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kryer për autoveturën tip “BMW X1”, shpenzimet e zhdoganimit, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruar dhe të evidentuara, për periudhën 1.1.2013 – 18.4.2013, duke rezultuar me një balancë paraprake negative në vlerën 1.352.390 lekë.

¹²Në deklaratimet periodike vjetore në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar kursime gjendje *cash* në banesë, konkretisht: në deklaratën për herë të parë në datë dorëzimi më 18.3.2004 ka deklaruar gjendje *cash* në banesë shumën 900.000 lekë; në DPV/ 2004 nuk ka deklaruar gjendje *cash*; në DPV/2005 ka deklaruar shtuar kursime familjare në shumën 300.000 lekë; (iv) në DPV-të për vitet 2006, 2007, 2008, 2009 dhe 2010 nuk ka deklaruar kursime në *cash*; në DPV/2011 ka deklaruar kursime nga të ardhurat e dy bashkëshortëve në shumën 1.000.000 lekë; në DPV/2012 ka deklaruar kursime nga të ardhurat e dy bashkëshorteve në shumën 1.200.000 lekë.

¹³Komisioni konstaton se kjo e ardhur nuk i përket subjektit të rivlerësimit, por vëllëzërve të tij të cilët kanë qenë qiradhënës të tokës mbi të cilën do të ndërtohej dhe pronarë të 400 rrënjëve lajthi te hequra nga shoqëria *** për ndërtimin e rrugës. Ky fakt provohet nga kontrata e qirasë, datë 22.8.2002. Analizuar në pikën 4 të pasurisë së llojit depozitë në “Tirana Bank”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

3.16 Njëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... asnjëherë nuk kam deklaruar që automjeti është blerë me të ardhurat e periudhës 1.1.2013 – 18.4.2013, por nga të ardhurat dhe kursimet ndër vite. Ky deklarim është edhe në deklaratën Vetting, nuk ka asnjë arsye që të analizohet si periudhë e burimit të blerjes 1.1.2013 – 18.4.2013...llogaritja e burimeve për këtë automjet duhet të bëhet mbi të gjithë bilancin e të ardhurave dhe të kursimeve të periudhës prill 1995 – 18.4.2013, duke llogaritur mbartjen e kursimeve të deklaruara në çdo vit...”

Nga ana e komisionit nuk janë vlerësuar të ligjshme dhe nuk janë llogaritur burimet e të ardhurave të siguruara nga Familja Bujqësore, të ardhura të deklaruara nga ana ime në emër të bashkëshortes...nëse do të përfshihen të gjitha këto të ardhura dhe mbarteshin kursimet e përvitshme, si dhe nëse do të mbahej parasysh jetesa e familjes time në fshat me shpenzime minimale jetese, në kushtet e një ekonomie ndihmëse familjare bujqësore, do të vlerësohet se ka patur burime të mjaftueshme për blerjen e autoveturës...”

Më tej, subjekti, në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti i “familjes bujqësore”, sqaron se¹⁴: “Nuk bëhet fjalë për ndonjë aktivitet tregtar të ushtruar nga bashkëshortja ime, të ardhurat e deklaruara në emër të saj janë të ardhura të siguruara nga aktiviteti i ‘familjes bujqësore’ deklarimi është bërë në emër të saj si personi madhor i familjes bujqësore që ishte angazhuar në mënyrë direkte dhe të përditshme me këtë aktivitet...”

Deklarimet e mia, ndër vite, mbi këto të ardhura janë tërësisht në përputhje me ligjin, bazohen mbi fakte të konfirmuara me vërtetimet përkatëse të lëshuara nga organet e pushtetit vendor, si të vetmet organe që mund të vërtetojnë dhe kanë vërtetuar faktin se ‘familja bujqësore’ e imja ka rreth 1 ha me lajthi në prodhim prej shumë vitesh, që merr prodhim të përvitshëm...”

Si pjesë e dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti me rezultatet e hetimit, është edhe raporti i audituesit ligjor A.M., i datës 2.12.2021, në të cilin është konstatuar, ndër të tjera, se subjekti dhe familjarët e tij kanë pasur burime të mjaftueshme për krijimin e kursimeve në cash për vitet 2003, 2011 dhe 2012.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

3.17 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

3.18 Udhëzimi nr. 4095, datë 10.10.2016, i ILDKPKI-së, si dhe formulari i deklarimi të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit jo vetëm për deklarimin e pasurisë së tij, por edhe të burimit në momentin e krijimit të saj dhe, për rrjedhojë, nga Komisioni është kryer një analizë financiare në datën 18.4.2013, datë në të cilën është blerë/krijuar pasuria, duke përfshirë shumën e likuiditeteve të mbartura deri më 31.12.2012 (të cilat janë deklaruar, si dhe është provuar mundësia financiare për krijimin e tyre), të ardhurat dhe shpenzimet, për periudhën 1.1.2013 – 18.4.2013, si dhe gjendjet e likuiditeteve në datën 18.4.2013.

¹⁴Referojuni prapësimeve të subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

3.19 Për pasqyrimin e gjendjeve *cash* në banesë, Komisioni është referuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në DPV-të, duke vlerësuar jurisprudencën e Kolegjit¹⁵, përcaktimeve në legjislacionin përkatës¹⁶, dokumentacionit ligjor justifikues të burimit të deklaruar, si dhe mundësinë financiare për krijimin dhe destinacionin e tyre.

3.20 Në deklaratën për herë të parë, datë 18.3.2004, në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në shumën 900.000 lekë me burim nga *“kontrata me firmën ***, për prishjen e 400 drurëve frutorë”*, ndërsa në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar shumën 942.000 lekë, si të ardhura nga marrëveshja e vitit 2003 me shoqërinë austriake ***, pra, për këto likuiditete të pretenduara të kursyera në fund të vitit 2003, subjekti e ka specifikuar burimin e krijimit.

3.21 Komisioni ka evidentuar fakti se subjekti nuk ka qenë konsekuent në gjithë deklaratimet e tij, pasi ka ndryshuar burimin e të ardhurave pas kalimit të barrës së provës duke deklaruar si burim të ardhurat e realizuara që nga viti 1995 dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e autoveturës në vitin 2013.

3.22 Në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga *“familja bujqësore”*, në deklaratimet periodike vjetore, subjekti ka deklaruar *“të ardhura të bashkëshortes nga vetëpunësimi në aktivitet privat frutikulturë”*, konkretisht, për periudhën 2003 – 2013, në vlerë totale 7.650.000 lekë¹⁷, por nuk ka provuar me dokumentacion si vetëpunësimin e bashkëshortes, ashtu edhe vlerën e deklaruar, konfirmuar kjo edhe nga deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* në të cilën shpjegon se: *“... për periudhën 2004-2014 nuk disponoj dokumentacion financiar, pasi tregtimi i produkteve bujqësore, arroje nga fermerët në këto vite bëheshin në tregun ambulant informal...”*.

3.23 Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“... deri në vitin 2015, por dhe aktualisht, tregtimi i produkteve bujqësore nga fshatarët me ekonomi bujqësore nuk ka qenë i formalizuar dhe nuk është i formalizuar në mënyrë të detyrueshme edhe aktualisht. Shitja e lajthive është bërë pjesë-pjesë në tregun ambulant. Tregtarët ambulantë e kanë blerë mallin në sasi të vogla dhe pa lëshuar dokumentacion për blerjen....”*.

3.24 Komisioni konstaton se referuar ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar¹⁸, nuk ka kufizim në regjistrim, në varësi të llojit të veprimtarisë ekonomike. Ekzistenca e vendimit nr. ***, datë 29.3.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, nëpërmjet së cilit znj. L. B., është njohur si person fizik privat për ushtrimin e aktivitetit privat në fushën e tregtisë së përgjithshme, por pa regjistruar këtë aktivitet në drejtorinë përkatëse tatimore, tregojnë se subjekti dhe bashkëshortja kanë qenë të informuar që në atë periudhë, se për të ushtruar një aktivitet tregtar kërkohej regjistrimi në gjykatë dhe më pas në organin përkatës tatimor, por kjo gjë nuk është finalizuar me regjistrimin në tatime.

3.25 Referuar informacionit si nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, Qendra Kombëtare e Biznesit, ashtu edhe nga deklaratimet e subjektit, për periudhën 2004 – 2014, bashkëshortja e subjektit nuk rezultoi e regjistruar pranë organit tatimor për aktivitet tregtar.

¹⁵Referuar jurisprudencës së Kolegjit (vendim nr. 29/2019 dhe nr. 11/2019).

¹⁶Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

¹⁷Pas ndryshimit të të ardhurave të deklaruara për vitin 2004, si rezultat i sqarimeve në prapësime të rezultateve e hetimit, ndërsa në deklaratën për herë të parë në datën 18.3.2004, subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga tregtimi i produkteve bujqësore (pretenduar dhe pasqyruar në vlerë 200.000 lekë në raportin e auditimit nga audituesi ligjor i kontraktuar nga subjekti).

¹⁸Neni 30, pika 1, ka parashikuar se: *“...çdo person e fiton të drejtën të ushtrojë veprimtari ekonomike vetëm pasi të regjistrohet në gjykatë. Pas këtij regjistrimi ai detyrohet të kërkojë pajisjen me certifikatë tatimore...”*.

3.26 Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në datën 29.6.2015, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me aktivitetin e bashkëshortes si e vetëpunësuar në bujqësi, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“...të ardhurat janë nga prodhimet bujqësore. Siç kam deklaruar, kam përfituar tokë nga ligji nr. 7501. Bashkëshortja ka punuar rregullisht... përveç kësaj ajo administron edhe 10 dynym pemëtari në pronësi të vëllait tim A. B., i cili është emigrant. Prodhimet e pemëve frutore ua ka shitur tregtarëve ambulantë, të cilët nuk i kanë vënë në dispozicion ndonjë dokumentacion për shitjen¹⁹...”*.

3.27 Duke u referuar sa më sipër, Komisioni vlerëson se pasja e tokës bujqësore nuk është faktor që mund të provojnë një aktivitet bujqësor tregtar fitimprurës dhe për më tepër vlerën e të ardhurave/fitimeve të realizuara për çdo vit për periudhën 2004 – 2014. Subjekti nga njëra anë pretendon *aktivitet të bashkëshortes si e vetëpunësuar, e cila ka punuar rregullisht duke administruar edhe tokën e vëllait të subjektit²⁰*, nga ana tjetër deklaron se bashkëshortja duke filluar nga viti 2012 ka qëndruar në Vlorë në adresën lagjja “***”, pallati pranë ***, gjatë ditëve të punës së subjektit si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë²¹. Gjithashtu, edhe ISSh-ja²², nuk konfirmon të dhëna në lidhje me kontribute të paguara nga viti 2012 dhe në vazhdim.

3.28 Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit se këto prodhime *iu shiteshin individëve/ shitësve të tjerë tregtare, ambulantë*, pra, nuk kanë qenë për përdorim personal por shitje me shumicë, rishitje, tregon se ky aktivitet dhe të ardhurat e pretenduara prej tij kanë qenë pjesë e një zinxhiri të ardhurash dhe blerjesh të padeklaruar, pasi deri në konsumatorin final vlera e këtyre prodhimeve, qoftë në formë natyrore, qoftë të përpunuara, është shtuar në varësi të normës së fitimit të aplikuar nga shitësit e tjerë tregtarë, të ardhura këto të paidentifikuara dhe për të cilat janë shmangur detyrimet përkatëse tatimore.

3.29 Deklarimet e subjektit se një pjesë e këtyre të ardhurave kanë qenë nga përdorimi i një sipërfaqe toke në pronësi të të vëllait, por të pashoqëruara me dokumentacion për funksionimin e marrëdhënies së përdorimit të tokës, zbatimin e saj, shpenzimet për punëtori, plehra kimikë/organikë, të tjera, si dhe mënyrën e ndarjes së fitimit, shtojnë paqartësi në lidhje me shumën (*neto/bruto*) të të ardhurave të deklaruara dhe realizuara nga ky aktivitet i pretenduar i bashkëshortes së subjektit.

3.30 Në bazë të pikës 7 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, është parashikuar se: *“Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme , të luajtshme, likuiditete..., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të , duhet të deklarojë burimin , në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacion ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre...”*.

3.31 Mbështetur edhe në jurisprudencën e Kolegjit²³, Komisioni vlerëson se pretendimet, prapësimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, për krijimin e të ardhurave të specifikuara *“nga vetëpunësimi i bashkëshortes në sektorin privat”*, për periudhën 2004 – 2014, mbeten në nivel deklarativ dhe nuk gjetën mbështetje të plotë në dokumentacion, pra, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e pretenduara në kuptim të nenit D, pika 3, fjalja 2, e Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se pasuri të

¹⁹Në mbështetje të shpjegimeve të tij subjekti ka bashkëlidhur vërtetim nr. *** prot., datë 17.3.2015, të lëshuar nga Komuna O. Gjirokastrë. Referuar këtij vërtetimi, bashkëshortja e subjektit ka përfituar nga ligji nr. 7501, tokë bujqësore në pronësi në fshatin “A. P.”, një sasi prej 11 dynym, të cilën e ka mbjellë me lajthi dhe pemë të tjera frutore në prodhim, gjithashtu, ka 10 dynym tokë bujqësore bllok me lajthi në prodhim të kunitit të saj, i cili ndodhet në emigracion të marrë me qira.

²⁰Përgjigje e pyetjes 3 në shpjegimet e dhëna për ILDKPKI në datën 29.6.2015.

²¹Përgjigje e pyetjes nr. 3, pyetësor nr. 2.

²²Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2020.

²³Vendimet nr. 8, datë 16.4.2019; nr. 32, datë 21.11.2019; nr. 26, datë 15.10.2020 të Kolegjit të Posacëm të Apelit.

ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, prandaj nuk mund të përfshihen në analizën e treguesve financiarë.

3.32 Në lidhje me raportin e ekspertimit dhe rezultateve të treguesve financiarë për vitet 2003, 2011 dhe 2012, pjesë të këtij raporti të paraqitur nga subjekti me prapësimet, në të cilin është konstatuar se subjekti dhe familjarët e tij kanë pasur burime të mjaftueshme për krijimin e kursimeve në *cash* për këto vite, Komisioni vlerëson se:

a) Të ardhurat e pasqyruara në këto analiza, konkretisht *nga shoqëria ****, referuar dokumentacionit të disponuar nga Komisioni nuk i përkasin subjektit të rivlerësimit, por vëllezërve të tij, ndërsa të ardhurat e pretenduara *nga vetëpunësimi në aktivitet privat frutikulturë të bashkëshortes së subjektit*, nuk provohen me dokumentacion ligjor për kohën, mënyrën e përfitimit, si dhe vlerën e saktë të tyre, për të cilën janë shlyer detyrimet përkatëse tatimore.

2. Përlllogaritjet e shpenzimeve minimale për konsum nga eksperti i autorizuar nuk kanë një bazë ligjore/statistikore apo metodikë llogaritjeje të miratuar/njohur dhe vlerësuar. Gjithashtu, në lidhje me këto shpenzime minimale për konsum, Komisioni vlerëson se, ndonëse subjekti dhe familjarët e tij deri në vitin 2012 kanë jetuar në fshat, të dhënat referuese nga INSTAT-i përfaqësojnë shpenzime minimale jetike në vlera të mesatarizuara, për më tepër që, për periudhën 2002 – 2013, subjekti dhe personat e lidhur kanë:

- i. pasur në përdorim edhe banesë në qytetin e Vlorës dhe Tiranës, për të cilat, përveç vlerës së qirasë së deklaruar nuk janë llogaritur shpenzime të tjera shtesë;
- ii. blerë, përdorur dhe nuk kanë deklaruar shitje për 5 automjete, për të cilat nuk janë llogaritur as shpenzime regjistrimi, taksa, siguracione, pjesë këmbimi, apo konsum karburanti.

Sa më sipër, referuar dokumentacionit të disponuar, deklaramëve të subjektit, si dhe shpjegimeve, provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke rezultuar me pamundësi financiare për blerjen e autoveturës tip “BMV X1”, në datën 18.4.2013.

4. Depozitë bankare në vlerën 3.800.000 lekë në “Tirana Bank” dhe gjendje *cash* në banesë në vlerë 1.400.000 lekë.

4.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar referencë të llogarisë së tij në “Tirana Bank”, në datën 27.10.2016²⁴, duke bashkëlidhur edhe: (i) certifikatë depozitë në “Tirana Bank”, me gjendje në vlerën 3.800.000 lekë; (ii) kontratë depozite me afat në “Tirana Bank”, datë 27.10.2016.

4.2 Në DPV-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar krijimin e kësaj llogarie depozitë në “Tirana Bank”, shumën e depozituar si dhe burimin e të ardhurave për krijimin e saj.

4.3 Referuar të dhënave nga “Tirana Bank”²⁵, rezulton se në datën 27.10.2016, është depozituar *cash* nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë rrjedhëse në lekë në emër të tij pranë kësaj banke shuma 3.800.000 lekë me përshkrimin “*kursime familjare për periudhën 1991 – 27.10.2016, të deklaruara në ILDKPKI*”, në të njëjtën ditë kjo shumë është futur në depozitë me afat 2- vjeçar në llogari në emër të subjektit po në “Tirana Bank”.

²⁴Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (aneksi nr. 4/5).

²⁵Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.10.2021, nga “Tirana Bank”.

Analizë e burimit të të ardhurave të deklaruar për krijimin e kësaj depozite

4.4 Në deklaratën *Vetting*, në lidhje me burimin e të ardhurave, subjekti ka deklaruar: “... nga kursimet familjare në periudhën²⁶ shkurt 1991 – dhjetor 2016”.

4.5 Gjithashtu, edhe në “Tirana Bank” në momentin e depozitimit të shumës prej 3.800.000 lekësh, subjekti ka deklaruar si burim *kursime familjare për periudhën 1991 – 27.10.2016*.

4.6 Referuar dokumentacionit të përcjellë nga subjekti me deklaratën *Vetting*, duket se jo të gjitha zërat e të ardhurave të deklaruara si burim për krijimin e kësaj depozite janë të justifikuar²⁷ me dokumentacionin ligjor vërtetues, në zbatim të pikave 7, 20, 21 dhe 22, të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, konkretisht:

i) Të ardhura të deklaruara nga puna e subjektit në emigracion në shtetin grek në periudhën shkurt 1991 – tetor 1992

4.7 Në lidhje me këto të ardhura, subjekti ka deklaruar punësim në të zezë si emigrant ekonomik. Në seksionin e të ardhurave dhe angazhimeve në veprimtari private dhe/ose publike në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar të ardhura të përfituara nga emigracioni, si dhe shumën e tyre.

Në deklaratën për herë të parë në datën 18.3.2004, subjekti deklaron gjendje *cash* në banesë në vlerën 900.000 lekë, por si burim për këtë shumë nuk ka deklaruar të ardhurat nga emigracioni, ndërsa burimi i deklaruar për autoveturën, me targa ***, në vitin 2002 (të ardhura familjare), në të cilat mund të jenë përfshirë edhe të ardhurat nga emigracioni, nuk mund të ketë shërbyer për krijimin e depozitës në vitin 2016, pasi kjo makinë nuk është shitur por ka dalë jashtë qarkullimit (pra, nuk janë përfituar të ardhura nga shitja).

4.8 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “... të ardhurat nga emigracioni përfshijnë shkurt 1991 – tetor 1992, si periudhë që nuk përfshihet në periudhën e deklarimit. Periudha e deklarimit në deklaratën *Vetting* përfshin periudhën nga koha e punësimit maj 1995 dhe në vazhdim. Në këtë kontekst, deklarimi im për përfitimet nga emigracioni në këto dy vite nuk përfshihet në detyrimet e mia për deklarim dhe nuk mund të përfshiheshin në seksionin ‘angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre’, në deklaratën *Vetting* apo në deklarimet e viteve që kanë filluar nga 2003 dhe më pas. Të ardhurat nga emigracioni në vitet 1991-1992, nuk mund ti provoj se sa kanë qenë, por mund t’ju them se kanë qenë shumë të konsiderueshme për kohën”.

4.9 Sa më sipër, Komisioni vlerëson se të ardhurat e deklaruara nga emigracioni, për periudhën shkurt 1991 – tetor 1992, në deklaratën *Vetting*, nuk janë deklaruar në deklaratën për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për pasuri, si dhe nuk justifikohen me dokumentacion përkatës ligjor.

ii) Të ardhura nga paga si ndihmës gjyqtar, gjyqtar, kryetar i gjykatës, gjyqtar në periudhën e viteve prill 1995 – janar 2017.

²⁶Subjekti ka deklaruar: “...Duke përfshirë veçanërisht të ardhurat nga: (i) puna ime në emigracion në shtetin Grek në periudhën shkurt 1991 – tetor 1992 (emigrant ekonomik, punësim në të zezë);(ii) të ardhura nga paga ime si ndihmës gjyqtar, gjyqtar, kryetar i gjykatës, gjyqtar në periudhën e viteve prill 1995 – janar 2017; (iii)-pensioni i pleqërisë i nënës time deri në datën e vdekjes më 24.5.2007; (iv) të ardhura nga aktiviteti i pemëtarisë si ekonomi e familjes bujqësore, në emër të bashkëshortes time Leferia Basho, e regjistruar si fermere private me Nipt ***, në periudhën e viteve 2005 – 2016, të ardhura të siguruara nga granti për bujqësinë të akorduar nga mini-granti Nr.***;(v) kontrata e dëmshpërblimit të një sasive pemësh me subjektin tregtar OMV, të deklaruara rregullisht pranë ILDKPKI për çdo vit; (vi) të ardhura nga puna e vajzës Ç.B. e punësuar pranë subjektit ‘***’ sh.p.k.. Nipt K***F, në vitet 2008 – 2009 dhe pranë Ministrisë së Mjedisit, në vitet 2011 – prill 2014; (vii)-të ardhura nga ekonomia ndihmëse familjare në formën e produkteve bujqësore ushqimore...”.

²⁷Me përjashtim të të ardhurave nga mini-granti Nr. ***, në shumën 9.750 USD.

4.10 Në deklaratën *Vetting* këto të ardhura janë deklaruar në vlerën 16.149.013 lekë. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur kësaj deklaratë²⁸ rezulton se të ardhurat e subjektit për këtë periudhë rezultojnë në vlerën 16.250.510 lekë²⁹.

iii) Pensioni i pleqërisë i nënës deri në datën 24.5.2007

4.11 Në deklaratën *Vetting* këto të ardhura janë deklaruar në vlerën 2.160.000 lekë, për periudhën prill 1995 – maj 2007.

4.12 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me dokumentimin e shumës së deklaruar, shpjegon se³⁰:
“.. kam ndërmarë të gjitha veprimet e mundshme pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Gjirokastër, kam kontrolluar dokumentacionin në Arkiv dhe më kanë lëshuar vërtetim nr. *** prot., datë 18.6.2021, me të cilin vërtetohet se në bazë të regjistrit përkatës rezulton se nëna ime është trajtuar me pensin familjar shtetëror nga dhjetor 1988 – maj 2007. Nuk gjendet në arkivin e këtij institucioni dosja përkatëse për të konfirmuar masën e pensionit”.

4.13 Komisioni, mbështetur në sa më sipër, vlerëson se, ndonëse nuk është dokumentuar vlera e saktë e pensionit të përfituar, por është vërtetuar trajtimi i saj me pension pleqërie, do të njihen për efekt të mbulimit të shpenzimeve të saj të konsumit.

*iv) Të ardhura nga aktiviteti i pemëtarisë si ekonomi e familjes bujqësore, në emër të bashkëshortes Lefteria Basho, e regjistruar si fermerë private me NIPT ***; në periudhën 2005 – 2016, të ardhura të siguruara nga granti për bujqësinë të akorduar nga mini-granti Nr.****

4.14 Në seksionin e angazhimeve dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre, pjesë e deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit të ardhurat nga vetëpunësimi në bujqësi të bashkëshortes i ka ndarë në dy grupe: (i) grupi i parë përfshin të ardhurat për periudhën 2004 – 2014, në vlerën 8.650.000 lekë, për të cilat subjekti pretendon se: “...tregtimi i produkteve bujqësore (arvore) nga fermerët në këto vite bëheshin në tregun ambulant informal...”; dhe (ii) në grupin e dytë subjekti ka deklaruar të ardhura nga vetëpunësimi në bujqësi e bashkëshortes në ekonominë familjare, rreth 11 dynym frutikulturë në prodhim në periudhën e viteve 2015 dhe 2016, regjistruar fermer me NIPT ***³¹, në vlerë 2.648.800 lekë³².

4.15 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, ka deklaruar se: “... deri në vitin 2015, por dhe aktualisht, tregtimi i produkteve bujqësore nga fshatarët me ekonomi bujqësore nuk ka qenë i formalizuar dhe nuk është i formalizuar në mënyrë të detyrueshme edhe aktualisht. Shitja e lajthive është bërë pjesë-pjesë në tregun ambulant. Tregtarët ambulantë e kanë blerë mallin në sasi të vogla dhe pa lëshuar dokumentacion për blerjen. Në vitin 2015 dhe 2016, bashkëshortja ime e reregjistruar si fermere me NIPT/SSN L***D, ka shitur prodhimin e viteve 2015 dhe 2016 jo në tregëtarë ambulantë por në një subjekt tregtar të licensuar, me faturën tatimore të shitjes, datë 18.12.2015, lëshuar nga subjekti blerës F.M...”

²⁸Vërtetim nr. *** prot., datë 14.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; vërtetim nr. *** prot., date 19.1.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

²⁹ Pa përfshirë vitet 2000 – 2001, për të cilat institucioni deklaroi se nuk disponon dokumente, për të cilat nga Komisioni këto vite u pasqyruan si mesatare të vitit 2000 dhe 2002.

³⁰Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

³¹Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti ka dorëzuar, ndër të tjera, edhe: certifikatë regjistrimi, datë 16.10.2015; kartë e fermerit nga DRBUMK Gjirokastër me datë lëshimi 16.9.2015; mandat tërheqje *cash*, të shumës 1.000.000 lekë, në BKT, datë 7.10.2016, nga L. B.; faturë tatimore shitje (vetëfaturimi) nr.***, datë 3.9.2016, me vlerë totale 2.070.000 lekë.

³²Për vitin 2015 të ardhura në shumën 1.648.800 lekë dhe për vitin 2016 shuma 1.000.000 lekë.

4.16 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve³³, informon se nga të dhënat e sistemit informatik, shtetasja L. B. nga data 16.10.2015 rezulton e regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë si Prodhues Bujqësor (fermer).

4.17 Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, me shkresë nr.*** prot., datë 18.8.2017, kthim përgjigjeje për ILDKPKI-në informon se: *“Subjekti ‘Fermer L. B.’, me NIPT ***, nuk ka deklaruar qarkullim dhe fitim në vite”*.

4.18 Në vazhdim të analizës së kryer më lart³⁴, për të ardhurat e pretenduara nga vetëpunësimi në bujqësi të bashkëshortes, nga Komisioni paraprakisht vlerësohet se nuk vërtetohet/dokumentohet ushtrimi i kësaj veprimtarie ekonomike tregtare nga bashkëshortja e subjektit³⁵, për periudhën 2004 – 2014, si dhe vlera e të ardhurave/fitimeve të deklaruara të përfituara³⁶.

4.19 Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga aktiviteti tregtar bujqësor i regjistruar me NIPT ***, për periudhën 2015 – 2016, nga Komisioni është vlerësuar të pasqyrohet në analizën paraprake vetëm shuma prej 1.000.000 lekësh, në vitin 2016, pasi është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2016, si dhe dokumentuar me tërheqjen *cash* të bashkëshortes nga BKT në datën 7.10.2016, ndërsa për vitin 2015 nuk vërtetohen në kohë dhe vlerë të ardhurat e pretenduara të përfituara.

iv) Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA), Granti për Bujqësinë

4.20 Në deklaratën *Vetting*³⁷, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, ndër të tjera, edhe të ardhura nga marrëveshja e datës 6.9.2011, midis L. B. në cilësinë fermere dhe mini-grantit Nr.***, Sektorit të Shërbimit teknik të MADA-s, pranë Ministrisë së Bujqësisë, në shumën 9.750 USD.

4.21 Në DPV-në e vitit 2011, subjekti në ndryshim të interesave pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme ka deklaruar, të ardhura nga marrëveshja e mini-grant CDRMA-100 me znj. L. B., MADA në shumën 10.000 USD (subvencion për përmirësimin e kushteve të prodhimit dhe tregtimit të pemëtarisë në bllokun privat O.).

4.22 Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së³⁸ në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“...të ardhurat e siguruar nga ndonjë mundësi e rastit siç janë kontrata me ***, Granti për bujqësinë etj., janë të ardhura që nuk i kam prekur por qëndrojnë si kursime familjare...”*.

4.23 Referuar marrëveshjes së mini-grantit Nr.***, lidhur në datën 6.9.2011, ndërmjet L. B. dhe Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) për *“punime rigjeneruese dhe përmirësim të ujtit në një bllok me lajthi”*, fondet e grantit që do t’i sigurohen marrësit nga MADA, duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllimin e specifikuar në propozimin e paraqitur nga marrësi³⁹.

³³Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2020.

³⁴Analizuar në pasurinë nr. *** , pjesë të këtij vendimi.

³⁵Dokumentacion në zbatim të pikës 22 të Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së.

³⁶Të ardhurat e deklaruara të përfituara nga vetëpunësimi i bashkëshortes së tij, në aktivitet privat frutikulturë, për periudhën 2004 - 2014, për të cilat mungon dokumentacioni justifikues ligjor, paraprakisht nuk do të përfshihen në analizën e treguesve financiarë.

³⁷Seksioni i angazhimeve dhe veprimtari private dhe /ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre.

³⁸Përcjellë me shkresë kthim përgjigje nr.*** prot., datë 10.2.2020, nga ILDKPKI-ja.

³⁹Pika 1.2 e marrëveshjes.

4.24 Në bazë të të dhënave nga BKT-ja, në llogari të bashkëshortes në dollarë në datën 24.11.2011 është transferuar shuma prej 9.750 USD me përshkrim “Mada likuidon L. B. për mini-granti”, në datën 25.11.2011 është tërhequr *cash* shuma prej 9.700 USD.

4.25 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3⁴⁰, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga marrëveshja e mini-granti e datës 6.9.201, ka sqaruar, ndër të tjera, se: “...nuk kemi shpenzuar në mënyrë të menjëhershme dhe brenda vitit shumën e vlerësuar nga specialistët e Grantit dhe nuk kemi kryer ndonjë shpenzim të menjëhershëm që tejkalon vlerën për deklaram mbi 300.000 lekë. Në vazhdim, destinacioni i shumës së dhënë nga Granti, nuk ka patur ndonjë destinacion të posaçëm. Shuma e tërhequr i është bashkuar gjendjes tonë financiare familjare, është bashkuar me kursimet dhe të ardhurat në vazhdim dhe është përdorur për shpenzimet familjare apo për kursimet familjare...”.

4.26 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, në deklaramet/shpjegimet e subjektit në lidhje me të ardhurat e përfituara nga mini-granti, si dhe destinacionin e tyre, vlerëson se referuar aktmarrëveshjes, datë 6.9.2011, të sipërcituar, të ardhurat e përfituara nga mini-granti janë përdorur për qëllimin e deklaram dhe miratuar të marrjes së grantit⁴¹. Pra, kjo shumë është dhënë dhe përdorur nga bashkëshortja e subjektit për aktivitetin e saj në fushën e bujqësisë dhe kurrsesi nuk mund të jetë përdorur si burim për krijim të pasurive nga subjekti dhe personat e lidhur.

4.27 Sa më sipër, Komisioni vlerëson se të ardhurat e pretenduara nga mini-granti për bujqësinë, sipas marrëveshjes, datë 6.9.2011, nuk mund të jenë përdorur si burim për krijimin e depozitës në “Tirana Bank”, në vitin 2016 dhe gjendjeve *cash* të deklaruara në deklaramen Vetting.

v) *Kontrata e dëmshpërblimit të një sasie pemësh me subjektin tregtar ***, të deklaruara rregullisht në ILDKPKI, për çdo vit*

4.28 Në deklaramen Vetting, subjekti ka deklaram shumën 942.000 lekë si të ardhura nga marrëveshja e vitit 2003 me shoqërinë austriake ***, subjekt që ka ushtruar aktivitet në ish-Komunën “O.”, në fushën e kërkimit të hidrokarbureve. Më tej, subjekti sqaron se: “... marrëveshja përfshinte shpërblimin për shkulljen (prishjen) e një sasie pemësh.... nuk kam ruajtur kontratën...”.

4.29 Në deklaramen për herë të parë në datën 18.3.2004, subjekti ka deklaram gjendje *cash* në banesë shumën 900.000 lekë, me burim nga kontrata me shoqërinë ***, për prerjen e 400 drurëve frutorë.

4.30 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaram, ndër të tjera, se: “... kjo firmë austriake në marrëveshje me shtetin shqiptar, shpronësoi një pjesë tokë bujqësore për nevoja të kalimit të rrugës dhe dëmshpërbleu fshatarët (familjet bujqësore) për tokën e shpronësuar dhe dëmtimin e të mbjellave. Në mungesë të dokumentit, me sa më kujtohet, me Kontratën e dëmshpërblimit për 400 bimë lajthi në vitin e 5 nga mbjellja, jemi dëmshpërblyer si familje bujqësore me rreth 800.000 lekë, mbi bazën e çmimit që ka referuar Ministria e Bujqësisë me kërkesë të Firmës dhe mbi 140.000 lekë jemi shpërblyer për qiranë e tokës të përdorur nga Firma për parkimin e mjeteve të rënda për ndërtimin e urës mbi lumin Drino...”.

4.31 Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se : “Gjithmonë kam pasur në kujtesë realizimin e kontratës së dëmshpërblimit për 400 bimë lajthi në vitin e 5 nga mbjellja, me shpërblimin me rreth 800.000 lekë, mbi bazën e çmimit të

⁴⁰ Përgjigje e pyetjes nr. 8.

⁴¹ Shuma e përfitur nga mini-granti në vitin 2011, nga Komisioni është vlerësuar që të mospasqyrohet në analizën financiare pasi ajo ka shërbyer për mbulim të kostove për të cilat është miratuar dhe dhënë ky mini-grant.

*referuar nga Ministria e Bujqësisë me kërkesë të firmës dhe rreth 100.000 lekë për qiranë e tokës të përdorur nga firma për parkimin e mjeteve për ndërtimin e urës mbi lumin Drino, tokë e cila përdorej nga ana e familjes time. Pas kërkimeve tek notere A. P., kam gjetur kontratën e datës 22.8.2002 të lidhur në emër të familjeve të vëllezërve të mi A. dhe I. B. dhe shoqërisë *** me përfaqësues M. N., pa praninë e tyre, pa akt përfaqësimi prej tyre dhe me praninë time...”.*

4.32 Subjekti, në mbështetje të pretendimeve të tij, ka depozituar në Komision, ndër të tjera, kontratë⁴², qiraje, datë 22.8.2002, ku në cilësinë e qiradhënësit janë shtetasit A. B. (vëllai i subjektit) dhe I. B. (vëllai i subjektit), si përfaqësues i bashkëshorteve dhe fëmijëve të tyre, ndërsa qiramarrëse është shoqëria ***, me përfaqësues z. M. N.. Subjekti ka nënshkruar këtë kontratë në cilësinë e përfaqësuesit të qiradhënësit⁴³. Nga përmbajtja e kontratës shuma prej 800.000 lekësh do të paguhet nga qiramarrësi për shkuljen e 400 rrënjëve lajthi dhe qiraja e tokës është 5lekë/m² në vit.

4.33 Sa më sipër, në shqyrtim të dokumentacionit të disponuar, Komisioni vlerëson se kjo e ardhur duket se nuk i përket subjektit të rivlerësimit, por vëllezërve të tij të cilët kanë qenë qiradhënës të tokës mbi të cilin do të ndërtohej rruga (ura) dhe pronarë të 400 rrënjëve lajthi të hequra nga shoqëria *** për ndërtimin e rrugës, pra, subjekti i rivlerësimit, nuk ka arritur të dokumentojë burimin e të ardhurave për shumën 942.000 lekë, të deklaruara të përfituara nga kontrata me këtë shoqëri, përdorur si burim për krijimin gjendjeve *cash* në banesë deklaruar në datën 31.12.2003, si dhe pasurive të tjera të krijuara më pas⁴⁴.

*vi) Të ardhura nga puna e vajzës Ç. B., e punësuar pranë subjektit “****” me NIPT ***, në vitet 2008 – 2009 dhe pranë Ministrisë së Mjedisit, në vitet 2011 – prill 2014*

4.34 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar shumën 800.000 lekë, të ardhura nga puna e vajzës Ç.B. e punësuar pranë subjektit “****” sh.p.k., në periudhën prill 2008 – nëntor 2009, me pagë 40.000 lekë/muaj⁴⁵.

4.35 Referuar të dhënave nga ISSh-s1⁴⁶ nuk konfirmohen periudha e kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar nga marrëdhëniet e punësimit me shoqërinë “****” sh.p.k. Gjithashtu, edhe nga informacioni i administruar nga bankat e nivelit të dytë, nuk rezultojnë kreditime në llogari në emër të vajzës në formën e të ardhurave nga paga të përfituara nga kjo shtetase për periudhën 2008 – 2009.

4.36 Sa më sipër, në shqyrtim të dokumentacionit të disponuar, Komisioni vlerëson se nuk u dokumentua marrëdhënia kontraktuale e punësimit, kushtet e punës/pagesës së personit të lidhur, vajzë madhore e subjektit, për periudhën 2008 – 2009, me punëdhënësin, si dhe nuk u depozitua dokumentacion provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave, për sa nuk u provua pagesa e detyrimeve përkatëse tatimore për to, nuk do të përfshihen në analizën e treguesve financiarë.

Nga subjekti nuk u dokumentua marrëdhënia kontraktuale, kushtet e punës/pagesës së bashkëshortes, për periudhën 2009 – 2010, me punëdhënësin, si dhe nuk u depozitua dokumentacion provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave, për sa nuk u provua pagesa e detyrimeve përkatëse tatimore për to.

⁴²Kontratë qiraje toke datë 22.8.2002.

⁴³Pa pasur një akt përfaqësimi nga qiradhënësi.

⁴⁴Të ardhurat e sipërpërmendura, për të cilat mungon dokumentacioni justifikues ligjor, paraprakisht nuk do të përfshihen në analizën e treguesve financiarë.

⁴⁵Subjekti ka bashkëlidhur vërtetim (pa datë) nga shoqëria “****” sh.p.k., me anë të cilit Ç. B. ka punuar në periudhën nga 2008 – 2009, dhe është paguar me rrogë bazë 40.000 lekë shtuar shpërblime në projekte të ndryshme.

⁴⁶Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.02.2020, të ISSh-ja.

Mbi likuiditetet gjendje *cash* të deklaruara, burimi i të ardhurave dhe mundësia financiare

4.37 Nisur nga fakti që në deklaratën *Vetting*, burimi i deklaruar i të ardhurave për krijimin e depozitës në shumën 3.800.000 lekë, në “Tirana Bank”, në vitin 2016, ka qenë i njëjtë me atë të gjendjeve *cash* në shumën 1.400.000 lekë, përveç sa u analizua më lart⁴⁷, nga Komisioni u shqyrtuan edhe deklaratimet e subjektit në ILDKPKI, për periudhën 2014 – 2016⁴⁸, duke analizuar mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur, për krijimin e kursimeve *cash* në banesë të deklaruara.

4.38 Në referencë të këtyre deklaratimeve nga subjekti, si dhe pamundësisë të rezultuar paraprakisht për blerjen e autoveturës në vitin 2013, vlera e akumulimeve *cash* deri në datën 31.12.2015, do të rezultonte në vlerën 2.500.000 lekë, ndërsa deri në datën 31.12.2016, do të rezultonte në vlerën 2.700.000 lekë (në DPV-në e vitit 2016, subjekti nuk ka deklaruar depozitën bankare në ‘Tirana Bank’, burimin e të ardhurave për krijimin e shumës 3.800.000 lekë, në datën 27.10.2016).

4.39 Në bazë të analizës së treguesve financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2014 dhe 2015, paraprakisht duket se subjekti ka pasur burime financiare të pamjaftueshme për krijimin e likuiditeteve gjendje *cash*, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara (konkretisht balanca paraprake e fondeve ka rezultuar negative përkatësisht në vlerat 1.583.519 lekë në vitin 2014⁴⁹ dhe 1.705.240 lekë në vitin 2015). Pra, në fund të vitit 2015 shuma e kursimeve *cash* të llogaritura duket se është 0 (zero) lekë.

4.40 Referuar dokumentacionit të disponuar dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, nga Komisioni u krye një analizë paraprake të treguesve financiarë, për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur (duke përdorur vetëm të ardhurat e dokumentuara për këtë periudhë)⁵⁰, për krijimin e depozitës në shumën 3.800.000 lekë, në emër të tij në “Tirana Bank”, shtesën në kursime *cash* në shumën 200.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për vitin 2016.

4.41 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit për sa duket se:

i) nuk ka deklaruar këtë pasuri dhe burimin e të ardhurave të krijimit, por ka deklaruar vetëm shtim të kursimeve në *cash* dhe jo pakësim të tyre në DPV-në vitit 2016.

ii) nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme, për të justifikuar krijim e depozitës bankare në shumën 3.800.000 lekë në vitin 2016, shtesën e deklaruar në kursime

⁴⁷Analizuar në pasurinë nr. ***, pjesë të këtij vendimi.

⁴⁸Subjekti ka deklaruar kursime gjendje *cash* në banesë, konkretisht: në DPV/2014, ka deklaruar shtesë në kursimet familjare në shumën 1.300.000 lekë; në DPV/2015, subjekti ka deklaruar shtesë në kursimet familjare në shumën 1.200.000 lekë; në DPV/2016, ka deklaruar shtesë në kursime në shumën 200.000 lekë, nga të ardhurat familjare.

⁴⁹Në të ardhura të vitit 2014, komisioni ka vlerësuar të mospërfshijë të ardhurat e përfituara nga shitja e autoveturës “Volksägen Golf”, me targë ***, për shumën 300.000 lekë, pasi subjekti nuk ka deklaruar në DPV/2014 as pakësim të pasurive dhe as të ardhurat e përfituara nga shitja në referencë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

⁵⁰Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti si fermere: subjekti në DPV/2016 ka deklaruar shumën 1.000.000 lekë; referuar të dhënave nga BKT me shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.10.2021, rezulton se në llogarinë në lekë në emër të bashkëshortes së subjektit në datën 5.10.2016 është transferuar shuma 2.070.000 lekë nga F. M., me përshkrimin “likuidim detyrimi”, ndërsa në datat 7.10.2016 dhe 10.10.2016, janë tërhequr *cash* përkatësisht shumat 1.000.000 lekë dhe 1.068.000 lekë.

cash në shumën 200.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016 (balancë negative në vlerën 3.966.850 lekë)⁵¹.

iii) për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit edhe për vlerën 1.400.000 lekë gjendje cash deklaruar në deklaratën *Vetting* me burim të ardhurash të njëjtë me depozitën në shumën 3.800.000 lekë në Tirana Bank, duket se ka mungesë të burimeve financiare për krijimin e saj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4.42 Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “... vlerësoj se duhet të mbahet parasysh se në deklaratimet vjetore të bërë nga ana ime nga viti 2003 dhe në vazhdim, janë bërë pa pasur njohuritë e nevojshme financiare dhe pa u orientuar nga specialist të fushës për elementet dhe detajet e deklarimeve...thelbësore në këto deklarime është që unë kam pasqyruar me vërtetësi të gjitha të ardhurat që kam përfituar, shpenzimet e deklarueshme dhe kursimet në vitet që kam pasur të tilla.

Komisioni ka marrë parasysh vetëm të ardhurat nga paga ime, të ardhurat nga pensioni i nënës time dhe të ardhurat e vajzës Ç. vetëm për kohën e punësimit në Ministrinë e Mjedisit. Të gjitha të ardhurat e tjera nuk janë marrë parasysh dhe nuk janë përfshirë në llogaritje, dhe në këtë mënyrë është nxjerrë një bilanc negativ.

Për mua e rëndësishme dhe thelbësore ka qenë të jem i vërtetë në deklaratimet e mia. Këto të ardhura kanë ardhur në familjen time dhe janë shpenzuar apo kursyer. Fakti që ka diskutime për dokumentacionin justifikues të plotë për ndonjë të ardhur të përfituar, nuk do të thotë se unë nuk i kam patur këto të ardhura...

*Në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga emigracioni, nuk janë deklaruar nga ana ime në deklaratën *Vetting*, duke qenë se bëhet fjalë për të ardhura të krijuara në vitet 1991-1992, si emigrant ekonomik në shtetin grek, tre vjet përpara se unë të filloja punë si nd/gjyqtar në sistemin e drejtësisë ...deklarimi im është bërë në kontekstin që këto të ardhura kanë ndikuar në kursimet e mia të mëvonshme, duke më krijuar një bazë për sigurimin e kushteve të jetesës së familjes time...deklaroj se këto të ardhura kanë qenë të depozituara në bankën greke ‘E...’ dhe janë tërhequr nga ana ime pjesë-pjesë në vitet në vazhdim pas kthimit nga emigracioni në nëntor 1992...jam interesuar për të marrë të dhëna nga kjo bankë dhe jam njohur me faktin se bankat nuk i mbajnë të dhënat e depozitave të mbyllura me kalimin e një kohe me mbi 25 vjet. Për raste të tilla nuk ekziston asnjë mundësi praktike për të siguruar dokumentacionin e kësaj depozite...*

*Në lidhje me të ardhurat nga punësimi i vajzës pranë firmës ‘***’ sh.p.k., bëhet fjalë për të ardhura në vlerë rreth 800.000 lekë, rezulton se nga ky subjekt janë lëshuar vërtetimet përkatëse, fakti që ISSH nuk konfirmon pagimin nga ana e këtij subjekti sigurimet e punësimit, nuk mund të përbëjë shkak që kjo periudhë punësimi dhe të ardhurat e përfituara të mos quhen të ligjshme dhe të mos llogariten në bilancin e treguesve financiarë... Nuk ka qenë detyrim i vajzës për të kryer pagesat e kontributeve në sigurimet shoqërore, por i punëdhënësit....*

*Në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti i ‘familjes bujqësore’, përveç sa parashtruar në qëndrimin e tij pas rezultateve të hetimit për pasurinë nr.***, subjekti ka sqaruar edhe:*

⁵¹Nisur nga fakti se deklarimi i subjektit për të të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti si fermere për vitet 2015 dhe 2016, nuk dokumentohet/përputhet plotësisht me dokumentacionin bankar të disponuar, Komisioni ka vlerësuar të pasqyrojë në analizën financiare paraprake vetëm shumën prej 1.000.000 lekë të deklaruar si të ardhura të bashkëshortes nga aktiviteti si fermere, për vitin 2016.

... të ardhurat nga prodhimi I ha lajthi nga viti 2004 dhe në vazhdim, janë të ardhura të ligjshme të nxjerra nga 'familja bujqësore', si strukturë ekonomike e njohur me ligj në aktivitetin familjar bujqësor, vërtetohen me vërtetimet e lëshuara nga pushteti vendor dhe nga një subjekt tregtar, deklaratimet janë në logjikën e mundësisë së të ardhurave që mund të sigurohen nga një aktivitet i tillë dhe duhet të përfshihen në analizën e treguesve financiarë...

Fakti që në disa vite (2015,2016 dhe 2017), prodhimi është blerë nga një subjekt tregtar i licensuar, është shlyer me faturat përkatëse dhe nëpërmjet bankës, shuma e shitjes është në masën 1.000.000 lekë në çdo vit, vërteton që krijon një besueshmëri dhe për masën e të ardhurave, të përfituara në mënyrë të përvitshme nga ky aktivitet në emër të bashkëshortes...

Për të ardhurat nga Mini-Granti, në shumën 9.750 USD, nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA), është proceduar në fillim me marrëveshjen, janë kryer punimet e investimit, janë verifikuar nga komisioni i posaçëm dhe më pas miratimit përfundimtar, janë derdhur në llogarinë bankare të fermerit...

Për të ardhurat nga shoqëria ***, në shumën 940.000 lekë, ju kam vënë në dispozicion kontratë qiraje për tokën datë 22.8.2002, prokurën e posaçme nr.***, datë 13.5.2005, të lëshuar nga familja e vëllait tim I. B. dhe prokurën e posaçme nr.***, datë 13.05.2005 të lëshuar nga familja e vëllait tim A. B.... nëse do ti referohemi këtyre deklaratimeve për shitjen e tokës në vitin 2005, përveç deklaratimit për të më zgjedhur si përfaqësues të posaçëm në shitjen e tokës bujqësore në pronësi dhe në emër të tyre, kanë deklaruar: E emërojmë si përfaqësuesin tonë z. Arqile Basho, edhe për faktin se neve si vëllazëri, kemi bërë bashkimin dhe pastaj rindarjen në mënyrë vullnetare të tokës e në këtë mënyrë ai ka dhe përfaqëson më mirë interesin e tij dhe interesat tona. Në analizë të këtyre fakteve, toka ku u shkulën ishte në AMTP në pronësi të tyre, por ato parcela i përdorja dhe i përdor unë edhe aktualisht, ato bimë i kishte mbjellë dhe rritur familja ime bujqësore dhe të ardhurat për dëmshpërblimin e tyre më takonin mua dhe i mora unë... ”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

4.43 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

Në lidhje me mosdeklarimin e krijimit të depozitës në DPV-në e vitit 2016 dhe burimin përkatës të krijimit

4.44 Në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve publike dhe të disa nëpunësve civilë”, i ndryshuar, neni 4 pika d, është parashikuar që: “... subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: ...d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj...”.

4.45 Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e konstatimeve, lidhur me mosdeklarimin e kësaj depozite, si dhe burimin e të ardhurave për krijimin e saj në DPV-në e vitit 2016.

Në lidhje me të ardhurat nga emigracioni

4.46 Referuar udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së⁵², pika 21 të këtij udhëzimi parashikohet se: “...deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklaramit si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare në territorin shqiptar...”.

4.47 Sa më sipër, lidhur me të ardhurat e pretenduara nga emigracioni, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e pretenduara në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se *pasuri e ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.*

Në lidhje me të ardhurat e vajzës nga punësimi pranë firmës “” sh.p.k.***

4.48 Nga Komisioni vlerësohet se edhe pas kalimit të barrës së provës nga subjekti i rivlerësimit nuk është arritur të provohet koha, mënyra, shuma e marrë, si dhe pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, në mënyrë që të konsiderohen të ardhura të ligjshme sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye, të ardhurat e pretenduara të vajzës së subjektit nga punësimi pranë firmës “***“ sh.p.k., nuk mund të merren në konsideratë në analizën e treguesve financiarë.

Në lidhje me të ardhurat në emër të bashkëshortes nga aktiviteti i “familjes bujqësore”

4.49 Nga Komisioni janë analizuar këto të ardhura të deklaruara nga subjekti, si dhe ligjshmëria e tyre edhe në analizën e bërë për pasurinë autoveturë tip “BMV X1”, blerë në vitin 2013 (pasuria nr. ***).

4.50 Përveç sa më sipër, Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar dhe deklaramet e subjektit, konstaton se bashkëshortja e subjektit është pajisur me kartën e fermerit nga DRBUMK Gjirokastër në datën 16.9.2015 dhe me certifikatë të regjistrimit pranë DRT-së Gjirokastër në datën 16.10.2015, pra, deri në këtë datë nuk është vërtetuar pasja e kësaj karte, për më tepër që edhe ISSH-ja⁵³ nuk disponon të dhëna për kontribute sigurimesh të paguara duke filluar nga viti 2012. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se pushteti vendor nuk mund të vërtetojë shumën e të ardhurave të përfituara nga një aktivitet “tregtar” dhe/ose “familje bujqësore”, për të cilën pretendon subjekti.

4.51 Lidhur me besueshmërinë e të ardhurave të pretenduara, Komisioni konstaton se në deklaratën *Vetting* subjekti ka bashkëlidhur faturën tatimore të shitjes (vetëfaturimi) nr.***, datë 3.9.2016, me vlerë totale 2.070.000 lekë, ndërsa referuar të dhënave nga BKT-ja⁵⁴, në datën 5.3.2018 është transferuar nga shtetasi F. M., shuma 1.904.400 lekë, me përshkrimin “*kalon në llogari të L. B. për likuidim fature të blera nga fermeri në datën 4.9.2016, nr.****”, pra, në periudhën 3.9.2016 – 4.9.2016, nga fermer L. B. (bashkëshorte e subjektit), është faturuar (në formë autofature) një shumë prej 3.974.400 lekësh (2.070.000 lekë+1.904.400 lekë). Këto të ardhura rezultojnë disa herë më të larta se të ardhurat e deklaruara periodikisht nga subjekti në periudhën 2004 – 2014 dhe në vlerësim të komisionit kalojnë kufijtë e besueshmërisë të një aktiviteti “modest” të pretenduar për një “familje bujqësore”.

⁵²Për mënyrën e deklaramit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

⁵³Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 11.2.2020.

⁵⁴Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.10.2021.

4.52 Në vazhdim të analizës së kryer më lart⁵⁵, nga Komisioni vlerësohet se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve në rezultatet e hetimit, duke mos arritur të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e pretenduara “nga vetëpunësimi i bashkëshortes në sektorin privat”, në kuptim të nenit D, pika 3, fjalë 2, të Aneksit të Kushtetutës.

Në lidhje me të ardhurat nga mini-granti

4.53 Në marrëveshjen e mini-grantit, të datës 6.9.2011, ndërmjet shtetasve L. B. dhe Agjencisë së Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) për “punime rigjeneruese dhe përmirësim të ujitjes në një bllok me lajthi”, fondet e grantit që do t’i sigurohen marrësit nga MADA, duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllimin e specifikuar në propozimin e paraqitur nga marrësi.

4.54 Mbështetur në këto parashikime, në vlerësim të faktit që kjo shumë është dhënë dhe përdorur nga bashkëshortja e subjektit për aktivitetin e saj në fushën e bujqësisë, nga Komisioni në analizën paraprake të treguesve financiarë shuma e përfituar nga ky mini-grant nuk është pasqyruar në të ardhura në vitin 2011, gjithashtu, nuk është përfshirë edhe në shpenzime për të njëjtën periudhë. Pra, ky mini-grant nuk ka pasur efekte në krijim kursimesh të cilat pretendohen të përdorura për krijim të pasurive në vijim.

Në lidhje me të ardhurat nga shoqëria ***

4.55 Komisioni, në lidhje me këto të ardhura, ka kryer analizën dhe vlerësimin e tyre më lart⁵⁶. Të ardhurat e përfituara nga shoqëria ***, referuar dokumentacionit të disponuar nga Komisioni nuk i përkasin subjektit të rivlerësimit, por vëllezërve të tij.

4.56 Bazuar në kontratën e qirasë për tokën, datë 22.8.2002, në cilësinë e qiradhënësit janë familjet bujqësore të shtetasve A. dhe I. B. (vëllezër të subjektit), subjekti ka firmosur këtë kontratë si përfaqësues i qiradhënësit (pa aktperfaqësimi). Në nenin 1 të kontratës, cilësohet së qiradhënësit janë pronarë të dy sipërfaqeve toke të cilat do të merren me qira nga qiramarrësi, ndërsa në nenin 2 është e përcaktuar heqja e 400 (katërqind) rrënjëve lajthi të cilat ndodhen në sipërfaqen e tokës të marrë më qira. Neni 4 i kontratës përcakton se: “Qiramarrësi i paguan qiradhënësit një shumë prej 800.000 (tetëqind mijë) lekë, për 400 (katërqind) rrënjë lajthi të hequra me qëllim të ndërtimit të rrugës hyrëse”.

Pretendimet e subjektit se bimët i kishte mbjellë dhe rritur familja e tij bujqësore dhe të ardhurat për dëmshpërblimin e tyre i takonin atij, nuk gjejnë mbështetje në kontratën e datës 22.8.2002.

Komisioni vlerëson se kjo e ardhur nuk i përket subjektit të rivlerësimit, por vëllezërve të tij, të cilët kanë qenë qiradhënës të tokës mbi të cilin do të ndërtohej rruga (ura) dhe pronarë të 400 rrënjëve lajthi të hequra nga shoqëria *** për ndërtimin e rrugës. Subjekti i rivlerësimit, nuk ka arritur të dokumentojë burimin e të ardhurave për shumën 942.000 lekë, të deklaruara të përfituara nga kontrata me shoqërinë ***.

5. Pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të znj. V. B., vajza e subjektit/ fëmija madhor e ndarë nga prindërit

5.1 Në deklaratën vjetore të interesave private të vitit 2015 e personit të lidhur/ fëmijë madhor i ndarë nga prindërit, vajza e subjektit ka deklaruar, ndër të tjera, se: (i) tokë arë, sip. 31 m², regjistruar në datën 19.5.2011, në emër të shtetasve J. G. dhe V. B., me adresë L.

⁵⁵Analizuar në pasurinë nr. 3, pjesë të këtij vendimi.

⁵⁶Analizuar në pasurinë nr. 3, pjesë të këtij vendimi.

,Tiranë. Çmimi i blerjes: 99.200 lekë. Burimi të ardhurat nga emigracioni në Greqi, J.G. për periudhën 1992 – 2008 dhe V. B., për periudhën 2002 – 2008; (ii) tokë arë, me sip. 694 m², regjistruar në datën 19.5.2011 në emër të J. G. dhe V. B., L., Tiranë. Çmimi: 2.220.800 lekë. Burimi: të radhuarat nga emigracioni J. G., për periudhën 1992 – 2008 dhe V. B., për periudhën 2002 – 2008; (iii) magazinë rreth 250 m², në proces legalizimi, ndërtuar në tokën në pronësinë V. B. dhe J. G. të përshkruar në pikat 1 dhe 2, me kursimet e punës në emigracion në Greqi, për periudhën 1992 – 2008.

5.2 Në deklaratën *Vetting*, në formularin e deklaramit të interesave private të personit të lidhur fëmija madhor i ndarë nga prindërit, znj. V. B. (vajza e subjektit) nuk i ka deklaruar këto pasuri.

5.3 Me shkresën nr.*** prot., datë 22.2.2018, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme i kthen përgjigje ILDKPKI-së, duke i bashkëlidhur shkresën e ZVRPP-së Tiranë me nr.*** prot., datë 19.2.2018, ku rezulton se znj. V. B. ka të regjistruar në pronësinë e saj, pasuri të paluajtshme në fshatin L., Tiranë, si vijon:

i. Pasuri me nr.***, vol. ***, f.***, z. k.***, lloji arë + truall, me sip. 725 sip. totale nga kjo 500 m² truall dhe ndërtesë 241.3 m² në bashkëpronësi (pasuri aktive). Pasuri e gjeneruar nga bashkimi i pasurive z. k.***, vol. ***, f. *** dhe vol.***, f.***, bashkëlidhur shkresës kartela e pasurisë, ku rezulton se pasuria është në pronësinë e J. G. dhe V. B., përfituar me leje legalizimi, datë 18.4.2017, godinë shërbimi 1 kat dhe 2 kat, kati përdhe 241.3 m² dhe kati i parë 17.9 m². Bashkëlidhur shkresës, gjithashtu, kontratë shitje nr.***, datë 7.5.2011, blerës J.G. dhe V.B., të pasurisë llojit arë me sip. 31 m² me nr. Pasurie ***, f.***, në vlerën 9.920 lekë + kontratë shitje nr.***, datë 7.5.2011, blerës J. G. dhe V. B., të pasurisë llojit arë me sip. 694 m² me nr. Pasurie ***, f.***, në vlerën 222.080 lekë.

ii. Pasuri me nr.***, vol. ***, f. ***, z. k.***, lloji pasurisë arë me sip. 725 m² sip. totale nga kjo 15 m² në bashkëpronësi. (pasuri aktive). Bashkëlidhur shkresës kartela e pasurisë, ku rezulton se pasuria është në pronësinë e J. G. dhe V. B., përfituar me kontratë shitje nr.***, datë 11.6.2016, me blerës J. G. dhe V. B., për pasurinë e llojit arë me sip. 15 m², në vlerën 6.720 lekë.

iii. Pasuri me nr.***, vol. ***, f. ***, z. k.***, lloji arë me sip. 725 m² sip. totale nga kjo 60 m², në bashkëpronësi (pasuri aktive). Bashkëlidhur shkresës kartela e pasurisë, ku rezulton se pasuria është në pronësinë J. G. dhe V. B., përfituar me kontratë shitje nr.***, datë 11.6.2016, me blerës J. G. dhe V. B., për pasurinë e llojit arë me sip. 60 m², në vlerën 26.880 lekë.

5.4 ALUIZNI Tirana Rurale, me shkresën nr. *** prot., datë 12.9.2017, informon ILDKPKI-në se praktika e plotë e subjektit V. B. administrohet nga kjo zyrë dhe i vë në dispozicion kopje të njehsuar të dosjes se legalizimit me vetëdeklarues J. G. dhe V. B..

5.5 ASHK-ja⁵⁷, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, informon Komisionin se nga verifikimi i bërë informacionit digjital, si dhe dokumentacionit që disponon ZVRPP-ja Tiranë, rezulton se:

Shtetasja V. B. ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasuritë me të dhënet, si vijon:

- i) pasurinë me nr.***, vol. ***, f.***, z. k.***, lloji i pasurisë arë me sip. 31 m² në bashkëpronësi, shuma e paguar për këtë pasuri 9.920 lekë;
- ii) pasuri nr. ***, vol. ***, f.***, z. k.***, lloji i pasurisë arë me sip. 694 m² në bashkëpronësi, blerë me çmim 222.080 lekë;

⁵⁷Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 9.3.2010.

- iii) pasurinë me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k.***, lloji i pasurisë arë+truall me sip. 725 m² nga kjo truall me sip 500 m² dhe ndërtesë mbi truall me sip. 241.3 m² në bashkëpronësi, me shënimin leje legalizimi datë regjistrimi 8.3.2018;
- iv) pasurinë me nr.***, vol. ***, f. ***, z. k.***, lloji i pasurisë arë, me sip. 60 m², në bashkëpronësi, blerë me çmimin prej 26. 880 lekësh, blerë më 11.6.2016;
- v) pasurinë me nr.***, vol. ***, f. ***, z. k.***, lloji i pasurisë arë, me sip. 15 m² në bashkëpronësi, blerë me çmimin prej 6.720 lekë, blerë në datën 11.6.2016.

5.6 ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Rurale ¹⁵⁸, sektori Juridik dhe i Bashkëqeverisjes, informon Komisionin se për sa i përket kërkesave për leje legalizimi rezulton se në emër të shtetasës Vasilika Basho, administrohet dosja e legalizimit nr. ***, datë 18.4.2017.

5.7 Komisionit i është përcjellë e gjithë praktika e legalizimit nga ASHK-ja. Sipas formularit të vetëdeklarimit me nr. *** prot., datë 30.9.2011, vetëdeklaruesit J. G. dhe V.B. deklarojnë se ndërtimi është ngritur në vitin 2011, si ndërtim pa leje me sip. 241 m² e ndërtuar në tokën e tyre, si objekt social ekonomik 1 kat dhe 2 kat. Në datën 18.4.2017, ALUIZNI ka lëshuar lejen e legalizimit për objektin me sip. 241.3 m² me 1 dhe 2 kate.

5.8 Nga dokumentacioni i administruar, rezulton se pasuritë e paluajtshme të sipërcituara janë blerë në datën 7.5.2011, nga vajza e subjektit dhe bashkëshorti. Gjithashtu, evidentohet që në datën 16.5.2011, subjekti i rivlerësimit ka kryer në “Credins Bank”, pagesat për tatimin mbi transferimin e pronësisë dhe detyrimet për regjistrimin e këtyre pasurive.

5.9 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se kjo pasuri (e llojit magazinë), me sip. 241 m², i është dhënë më qira, për periudhën 2017 – 2018, shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, ku vajza e subjektit V. B. për periudhën mars 2017 – gusht 2018, rezulton e regjistruar si punonjëse pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, ndërsa djali nga shtatori i vitit 2018, rezulton i regjistruar në listëpagesat e kësaj shoqërie si punëtor makine bluarje.

5.10 Referuar të dhënave nga Qendra Kombëtare e Biznesit⁵⁹, konkretisht në ekstraktin historik të shoqërisë “****” sh.p.k., është pasqyruar hapja e një adrese sekondare në datën 31.10.2012, duke shtuar adresën “Tiranë, V., L.; rruga “****”, mbrapa depozitave të gazit të shoqërisë ***”. Kjo shoqëri në atë periudhë ka pasur si ortak të vetëm dhe administrator z. J. B. (djalin e vëllait të subjektit të rivlerësimit).

5.11 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3⁶⁰, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, ndër të tjera, se: *“...shoqëria ‘****’ sh.p.k., me NIPT ***, me administrator J.B., është shoqëri në pronësi të tre nipërve të mi, djemve të vëllait tim I. B., P. B., J. B. dhe L. B.. Përveç marrëdhënieve vëllazërorë si fëmijët e vëllait tim, nuk kam patur dhe nuk kam me shoqërinë e tyre, as unë dhe as ndonjë nga fëmijët e mi, ndonjë marrëdhënie që lidhet me pronësinë e saj, aktivitetin e saj apo të çfarëdo lloj marrëdhënie që lidhet me punën e tyre. As unë dhe asnjë nga fëmijët e mi nuk kanë lidhje me investimin e kryer që nga vëllai im në kohën e gjallërisë dhe nga nipërit e mi në vazhdim dhe nuk kemi patur dhe nuk kemi asnjë lidhje me aktivitetin e kësaj shoqërie. E vetmja lidhje, nëse mund të quhet e tillë, me këtë shoqëri është fakti që ata ju gjenden pranë vajzës time V. B. në Janar 2017... duke i marrë me qira magazinën⁶¹ në pronësi të tyre të ndodhur në fshatin L., Komuna K., për aktivitetin e riciklimit të polietilenit (plasmasit). Njëkohësisht, me aktivitetin e riciklimit në këtë magazine, kanë angazhuar me punë vajzën time V., kushërirën e tyre...dhe djali im Ll. B. ndërpreu studimet nga Fakulteti i*

⁵⁸Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 2.3.2020.

⁵⁹Faqja zyrtare online.

⁶⁰Përgjigje e pyetjes nr. 8.

⁶¹Në përgjigje të pyetësorit subjekti ka bashkëlidhur edhe disa deklarime të administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k.

Farmacisë A. U. (të cilin ende nuk e ka përfunduar) dhe u angazhua pranë të motrës për ta ndihmuar... në kushtet kur ajo e vetme nuk mundej të administronte repartin e riciklimit”.

5.12 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe deklaratimet e subjektit, vlerëson se subjekti dhe/ose personi i lidhur (fëmija madhor i ndare nga prindërit) nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting*⁶², pasuritë në emrin e vet ose pjesën e saj në bashkëpronësi.

- Ka pasaktësi në lidhje me vlerën e blerjes së tokës arë me sip. 694 m², në L., Tiranë, në bashkëpronësi të vajzës së subjektit dhe bashkëshortit, deklaruar në DPV-në e vitit 2015, në vlerën 2.220.800 lekë, kurse sipas kontratës së shitjes vlera është 222.080 lekë.

- Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, vajza madhore e ndarë nga prindërit, nuk ka deklaruar në DPV-të e viteve 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2016, në deklaratën përkatëse të interesave private të personit të lidhur këto pasuri, të ardhura dhe ose detyrime financiare ndaj personave juridike dhe fizike.

- Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar/dokumentuar burimin e të ardhurave të vajzës madhore dhe bashkëshortit të saj për krijimin e këtyre pasurive në vitin 2011 (përfshirë dhe jo vetëm koston e ndërtesës në vlerë afërsisht 7.200.000 lekë⁶³, e cila sipas deklaratës “Për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa lejë dhe/ose shtesës në ndërtim me leje”, nr. *** prot., datë 30.9.2014, është ndërtuar në vitin 2011).

- Subjekti ka kryer vetë transaksione/pagesa për tatimin mbi transferimin e pronësisë dhe detyrimet për regjistrimin e këtyre pasurive në “Credins Bank”, për ZVRPP-në Tiranë (më 16.5.2011).

- Nuk provohet marrëdhënia e vajzës së subjektit dhe bashkëshortit të saj me këto pasuri, pasi ato kanë jetuar prej vitesh në Greqi dhe nuk të krijojnë bindjen se janë pronaret *de facto* të këtyre pasurive.

- Ka deklarime jo koherente në lidhje me administrimin nga vajza dhe djali i subjektit të rivlerësimit të repartit të riciklimit pjesë e aktivitetit të shoqërisë “***” sh.p.k., në ambientet në pronësi të vajzës dhe në përdorim të kësaj shoqërie, ekzistencë së marrëdhënies së dokumentuar të punësimit të tyre, me qëndrimin e vajzës së tij në shtetin gjerman.

- Subjekti nuk ka deklaruar/dokumentuar marrëdhënien kontraktuale qiraje, huapërdorje ose marrëdhënie tjetër midis shoqërisë “***” sh.p.k. dhe vajzës së subjektit shoqëruar me mosdeklarimin në deklaratat e interesave private të personit të lidhur (për periudhën 2012 – në deklaratën *Vetting*), të marrëdhënies së interesit e cila ka filluar që në vitin 2012.

- Subjekti ka qenë i autorizuar edhe nga ortaku i kësaj shoqërie për administrimin/shitje të pasurive familjare, në bazë të prokurës së posaçme nr. *** , datë 13.5.2005.

- Subjekti ka deklaruar në pyetësor, që ka përdorur pasuri të luajtshme në pronësi të ortak/administratorit të shoqërisë “***” sh.p.k.

5. 13 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se:

⁶²Pasurinë lloji arë + truall, me sip. totale 725 m², nga kjo 500 m² truall dhe ndërtesë 241.3 m², përfutur me leje legalizimi datë 18.4.2017 (godinë shërbimi 1 kat dhe 2 kat, kati përdhe 241.3 m² dhe kati i parë 17.9 m²) dhe vlerës së ndërtimit në fshatin L.-Tiranë, në bashkëpronësi të V. B.(vajza e subjektit) dhe shtetasit J. G. ; pasurinë e llojit arë me sip. 15m², në fshatin L., Tiranë, në bashkëpronësi të V. B. (vajza e subjektit) dhe shtetasit J. G. ; pasurisë lloji arë, me sip. 60 m², në fshatin L., Tiranë, në b/pronësi të V.B. (vajza e subjektit) dhe shtetasit J.G..

⁶³Referuar udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2011”, rezultoi se kosto mesatare e ndërtimit në qytetin e Tiranës ka qenë 29.910 lekë/m² sipërfaqe ndërtimi. Për sipërfaqen 241 m² vlera e përafërt e ndërtimit ka qenë rreth 7.200.000 lekë.

- i) subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë pasurinë në emër të vajzës së tij madhore;
- ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur një lidhje interesi me shoqërinë “***” sh.p.k., të cilat janë munduar të fshihen;
- iii) me veprimet e mosveprimet e kryera ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

5.14 Në lidhje me këtë pasuri të konstatuar nga Komisioni, si pasuri e fshehur e subjektit, subjekti në prapësimet e tij, ndër të tjera, sqaron se: *“Nuk kam pasur asnjë mundësi dhe as ndonjë arsye për të fshehur pasurinë time tek fëmijët e mi. Unë dhe fëmijët e mi nuk kemi pasur asnjë lidhje interesi me shoqërinë ‘***’. Nuk janë marrëdhënie kontraktore ato që kam me pronarët e shoqërisë ‘***’ janë marrëdhënie njerëzore. Përpara ILDKPKI-së kam thënë se vajza ime është shkëputur nga familja në qershor të vitit 2004 për shkak të bashkëjetesës me bashkëshortin e saj J. G., me të cilin ka lidhur martesë në vitin 2010 pas lindjes së fëmijëve. Shtetasi J. G. ka ndërruar jetë në 1.1.2017 dhe vajza ime me dy fëmijë të mitur jeton në Gjermani, aty jeton edhe vajza tjetër Ç. B. D.. I ndjeri dhëndri im ka jetuar 16 vjet në emigracion ndërsa vajza ime 4 vjet. Pasuria është ndërtuar në vitin 2011 dhe për këtë kanë kontrata e blerjes së pasurisë së paluajtshme. Formular vetëdeklarimi për ndërtimin informal, leje legalizimi përfituar në emër të vajzës V. dhe bashkëshortit të saj J. G.. Nuk ka arsye të mendohet që kjo pasuri është e imja vetëm se kam paguar pagesat për aplikimin e regjistrimit të pasurisë, pasi ata kanë qenë të huaj në Tiranë, vinin nga emigracioni dhe nuk orientoheshin me zyrat e shtetit. Në deklaratën Vetting kam pasur detyrimin të deklaroj vetëm të ardhurat, shpenzimet e deklarueshme, pasurinë dhe kursimet e krijuara nga ana ime dhe anëtarëve të familjes në kohën e deklaramit. Në kohën e deklarimit familja ime përbëhej nga bashkëshortja dhe unë. Pasuria e mësipërme nuk është krijuar nga ana ime dhe e anëtarëve të familjes time është krijuar nga shtetasi J. G. që është bashkëshorti i vajzës sime dhe nuk është subjekt deklarues. Në konkluzion nuk kam pasur detyrimin ligjor të deklaroj pasurinë e krijuar nga një shtetas që nuk është në rrethin e personave të lidhur, qoftë edhe pasurinë e një personi të lidhur që është ndarë nga subjekti deklarues. Sa i takon pasaktësisë në lidhje me vlerën e blerjes së tokës arë në L.të Tiranës, janë gabime materiale të kryera nga noteri në momentin e hartimit të kontratave të shitjes të realizuar nga shtetasi J. G. dhe bashkëshortja e tij, me shitësin. Në rastin konkret është një pasuri e krijuar nga bashkëshorti i vajzës time nga jeta në emigracion në shtetin grek për 16 vjet”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

5.15 Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim të gjitha provat që rezultuan nga hetimi administrativ, në lidhje me këtë pasuri, deklaramet e subjektit në deklaratën vjetore të vitit 2015, si dhe shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, vlerësoi se:

5.16 Në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016⁶⁴, subjekti ka barrën e provës në këtë proces, nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e ligjshme të vajzës dhe bashkëshortit të saj të krijuara nga emigracioni. Subjekti nuk ka sjellë prova dhe për të treguar qëndrimin, punësimin dhe të ardhurat që ka përfituar vajza e tij madhore dhe bashkëshorti i saj, për 16 vjet në Greqi.

5.17 Nga hetimi administrativ rezultoi se subjekti ka pasur marrëdhënie me këtë pronë që në vitin 2011, të cilën nuk e ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore nuk e ka deklaruar as në

⁶⁴Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë arritur nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime. Parashikimet e nenit 82 të Kodit të Procedurës Administrative nuk zbatohen.

deklaratën *Vetting*⁶⁵. Kryerja e pagesave të tatimit për kalimin e pronësisë në “Credins Bank” nga subjekti, janë sjellje që kanë si rezultat përfundimtar se ai është pronari *de facto* i kësaj prone.

5.18 Punësimi i vajzës (bashkëpronare e kësaj pronë) dhe i djalit të subjektit si punëmarrës të shoqërisë “****” sh.p.k., regjistrimi i adresës së kësaj shoqërie në këtë pronë, marrëdhënia e subjektit me administratorin dhe ortakët e saj të çojnë në konkluzionin së kjo pasuri është një pasuri e fshehur e subjektit.

5.19 Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, vajza madhore e ndarë nga prindërit, duke mos deklaruar në deklarata periodike vjetore të viteve 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2016, këto pasuri, nuk ka përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara nga neni 4 i ligjit nr. 9049/2003, i cili sanksionon se subjekteve deklarues detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri me 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si vijon: (a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to; (b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publike; (c)... etj.

5.20 Në të njëjtë frymë ligjore ka dalë për zbatimin edhe udhëzimi nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, i Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, që doli në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, i cili në pikën 4 përcakton se kur pasuria e personave të lidhur (bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhorë) është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas dhe i bashkëlidhet deklaratës së subjektit të rivlerësimit.

5.21 Trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues për të vërtetuar marrëdhënien kontraktuale të qirasë ose ndonjë marrëdhënie tjetër juridike midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe vajzës së tij, marrëdhënie e cila ka filluar që në vitin 2012.

5.22 Komisioni në vlerësim të rrethanave dhe fakteve si: marrëdhënia e punësimit të vajzës së subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k., qëndrimi i saj në Gjermani, deklaratimet kontradiktore të subjektit në lidhje me administrimin nga vajza dhe djali i subjektit të rivlerësimit të repartit të riciklimit pjesë e aktivitetit të shoqërisë “****” sh.p.k., në ambientet në pronësi të vajzës dhe në përdorim të kësaj shoqërie, dhe mosprovimit nga ana e subjektit të burimit të ligjshëm të pasurisë së paluajtshme regjistruar në emër të znj. V. B./vajza e subjektit ka arritur në konkluzionin se subjekti gjendet në lidhje me këtë pasuri në situatën e parashikuar prej pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c”, e ligjit nr. 84/2016.

6. Pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të vajzës së subjektit Ç. B., në Gjermani

6.1 Në DPV-në e vitit 2018, subjekti në deklaratën e interesave private të personit të lidhur/vajza Ç. B., ka deklaruar depozitë bankare në emër të T. B., në shumën 23.928 euro dhe bashkëshorti M. D., në shumën 10.783 euro, me burim nga pagat në Gjermani. Gjithashtu, personi i lidhur ka deklaruar edhe kredi bankare me shumë të shlyer 1.200 euro dhe detyrim të mbetur 13.828 euro.

⁶⁵Vendimi i GjEDNj-së, Xh. kundër Shqipërisë, 9 shkurt 2021, paragrafi 406: [Gjykata vëren se institucionet e rivlerësimit shqyrtuan deklaratën e pasurisë për rivlerësim të kërkuarës. Në përputhje me ligjin nr. 84/2016, kërkuarës iu kërkua të justifikonte burimet e ligjshme fillestare të cilat kishin shërbyer si bazë për përfitimin e pasurive të saj. Gjykata përsërit, se në përputhje me angazhimet në traktate të Shqipërisë, kërkesa për deklarimin e pasurive dhe justifikimin e origjinës së tyre të ligjshme është futur në legjislativonin e brendshëm që nga viti 2003, i cili përmban, gjithashtu, sanksione për mosdeklarimin e pasurive ose deklarimin e rremë të tyre. Kjo është arsyeja pse ligji nr. 84/2016, siç konfirmohet më tej nga Kolegji, ka parashikuar përdorimin e deklaratave të mëparshme të pasurive si prova për të verifikuar vërtetësinë e deklaratës së pasurisë për rivlerësim].

6.2 Subjekti, në pyetësonin nr. 3, është pyetur në lidhje me burimin e krijimit të këtyre depozitave (duke analizuar dhe dokumentuar në kohë dhe vlerë këtë burim) dhe a kanë krijuar pasuri të tjera të paluajtshme dhe të luajtshme vajzat në Gjermani.

6.3 Subjekti, në përgjigje të kësaj pyetje, deklaroi se: *“Vajza Ç. ka lidhur martesë në korrik 2014 dhe nga kjo kohë është emigrante me dokumentacion të rregullt në Gjermani. Bashkëshorti i saj M. D. ka rreth 13 vjet emigrant në Gjermani. Për të gjitha të ardhurat, kreditë, shlyerjet e kredisë, detyrimet etj., që ka deklaruar vajza ime Ç. B., së bashku me bashkëshortin e saj M. D., sqaroi se ata janë familje më vete që nga viti 2014 dhe jetojnë dhe punojnë prej shumë vitesh në Gjermani. Deklarimin e kanë bërë mbi kërkesën time me qëllim që çdo gjë të jetë e qartë edhe me personat e lidhur me mua si subjekt deklarues dhe mbi konfuzionin e orientuar nga inspektorë të ILDKPI-së. Nuk janë subjekte deklarues dhe unë si subjekt deklarues nuk kam dijeni në detaje mbi të ardhurat e siguruara dhe kursimet e siguruara prej tyre. Ju kam kërkuar shpjegime, më kanë konfirmuar se gjithshka në të ardhurat dhe kursimet e tyre është e dokumentuar në mënyrë të ligjshme dhe janë të gatshëm të japin çdo shpjegim dhe dokumentacion para jush”*.

6.4 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se personi i lidhur me subjektin nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues mbi burimin e krijimit të depozitës në emrin e saj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

6.5 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Ju kam paraqitur të dhëna dhe dokumentacion për të ardhurat e siguruara nga Ç. për aq sa ishte në familjen time me dokumentacionin përkatës si dhe ju kam parashtruar rrethanat e kalimit të saj në Berlin Gjermani. Kam depozituar DVP-në e vitit 2018 me qëllim që të për të paraqitur gjithë situatën financiare të saj. Në deklaratimet e mia kam sqaruar se vajza ime Ç. është lidhur në martesë më bashkëshortin e saj në korrik të vitit 2014 dhe nga kjo kohë është emigrante në Gjermani. Bashkëshorti i saj M. D. ka qenë emigrant me familjen në Greqi 5-6 vite para lidhjes së martesës, me pas ka kaluar emigrant në Gjermani. Për të gjitha të ardhurat, kreditë, shlyerjet e kredisë, detyrimet etj. që ju ka deklaruar vajza ime së bashku me bashkëshortin, ata janë familje më vete që nga viti 2014 dhe jetojnë dhe punojnë në Gjermani. Në dijeninë time edhe aktualisht ata nuk kanë krijuar ndonjë pasuri të paluajtshme. Sa i takon dokumentacionin të bilanceve financiare të tyre zyrtar shtetërore nuk ja u kanë refuzuar marrjen e tyre, por marrja e dokumentacionin është kundërt pagesave prej 480 euro personi dhe për tre persona duhet të paguajnë 1.500 euro. Në pamundësi për të përballuar këto tarifa u është rekomanduar marrja e tyre nëpërmjet institucioneve shtetërore procedura që kryhen me lehtësi midis shteteve. Unë si subjekt i deklaratimit nuk kam ndonjë mundësi konkrete për të siguruar dokumentacionin e kërkuar. Barra ime e provës për të paraqitur të dhënat mbi të ardhurat dhe kursimet e vajzës time në Gjermani përfundon me mungesën e të drejtës time për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm”*.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

6.6 Subjekti në shpjegimet e tij në pyetësonin, por edhe në shpjegimet pas kalimit të barrës së provës, nuk vërtetoi me dokumentacion ligjor provues kohën e krijimit të depozitës në emër të vajzës së tij, si dhe burimin e deklaruar të të ardhurave për krijimin e kësaj depozite. Nisur nga fakti që në DPV-në e vitit 2018 vajza e subjektit deklaroi si burim të kësaj depozite të ardhurat nga paga në Gjermani në 4 (katër) vjet.

6.7 Komisioni vlerëson se subjekti në këtë proces ka barrën e provës të vërtetoje të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues, burimin e të ardhurave për krijimin e depozitës në emrin e vajzës.

7. Në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar si vendqëndrime të tjera edhe apartamentet në lagjen “*”, Vlorë dhe në rrugën “***”, Tiranë.**

7.1 Lidhur me apartamentin në rrugën “**”, Tiranë**

7.1.1 Në përgjigje të pyetësorit standard në lidhje me apartamentin e banimit në rrugën “****”, Tiranë, subjekti ka deklaruar: *“Në periudhën 2014 e aktualisht kemi marrë me qira për nevoja të sistemimit të fëmijëve Ç. dhe L. B., apartament 2+1 në pronësi të shtetasit B. P. (A. P.), qiraja në shumën 18.000 lekë në muaj deri në shtator 2018 është paguar nga kursimet familjare. Me punësimin e djalit qiraja është paguar sipas kushteve të kontratës së qirasë nr. ***, datë 7.1.2018, lidhur midis qiradhënësit B. P. dhe Ll. B., në shumën 18.000 lekë”.*

7.1.2 Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 në lidhje me adresën në rrugën “****”, Tiranë, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar: *“Ishte adresa e vendqëndrimit të vajzës time Ç. dhe djalit L. (2013), më vonë ata u transferuan me gjendje civile në Tiranë dhe kanë përdorur këtë banesë me qira. Aktualisht në këtë adresë banon djali im L. me familjen e tij. Duke shkuar pranë tyre e kam deklaruar si adresë të përdorur prej meje gjatë fundjavave”.*

7.1.3 Referuar deklaramenteve periodike vjetore pranë ILDKPKI-së, rezultojnë se: (i) në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar vendqëndrimin tjetër në adresën: Tirana e Re, ish-stacioni i fundit, rruga “****”, p.***, ap. ***, shk. ***, Tiranë; (ii) në DPV-në e vitit 2014 e në vijim subjekti nuk e ka deklaruar përdorimin e kësaj adrese, përveç adresës së plotë në fshatin A. P., Gjirokastër; (iii) në DPV-në e viteve 2015 dhe 2016 nuk ka deklaruar as adresë regjistrimi në gjendje civile dhe as vendqëndrim tjetër në Tiranë për familjaret e tij; si dhe (iv) për vitet 2013 - 2016 nuk vërtetohet lloji i marrëdhënies midis palëve në lidhje me këtë pasuri dhe as nuk deklarohen këto marrëdhënie nga subjekti.

7.1.4 Në bazë të dokumentacionit të përcjellë nga noterja M. E.⁶⁶, shtetasi A. P., i datëlindjes 14.10.1967, ka lidhur një kontratë porosie në datën 23.12.2009 me shoqërinë “****” sh.p.k. Në bazë të kësaj kontrate ai ka porositur pranë kësaj shoqërie ndërtimin e apartamentit 2+1, me sipërfaqe të përgjithshme 103 m² + 9,8 m² sipërfaqe e përbashkët, me nr. 8, k. 3 popullor, kundrejt vlerës 92.700 euro, e likuiduar totalisht në momentin e nënshkrimit të kontratës.

7.1.5 Nisur nga vendndodhja dhe sipërfaqja e apartamentit dhe çmimi i blerjes nga qiradhënësi, duket se edhe vlera e deklaruar e qirasë prej 18.000 lekësh/muaj, e pandryshuar që nga viti 2012 e në vazhdim, përveç çmimeve të tregut nuk mbështetet në logjikë ekonomike dhe ngre dyshime për një marrëdhënie tej asaj të qirasë.

7.1.6 Nisur nga faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit dhe shqyrtimit të kësaj çështjeje, rezultojnë se: (i) ekziston marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me apartamentin për shkak të përdorimit ndër vite prej subjektit gjatë fundjavave dhe në vijimësi nga viti 2012 nga fëmijët e tij; (ii) nuk provohet bindshëm marrëdhënia e porositësit me këtë apartament, pasi porositësi jeton prej vitesh në Greqi dhe vjen në Shqipëri vetëm gjatë festave të fundvitit, në muajin dhjetor; (iii) nga viti 2012 deri në vitin 2016 nuk provohet me dokumentacion ligjor dhe as nuk vërtetohen deklaramentet e subjektit për marrëdhënien midis palëve dhe nga viti 2014 deri në vitin 2016 nuk deklarohen nga subjekti në deklaramentet periodike të tij këto marrëdhënie me apartamentin në fjalë; (iv) fakti se kontrata e qirasë e nënshkruar nga palët në vitin 2018 ka referuar vlerë qiramarrjeje prej 18.000 lekësh/muaj, vlerë e cila, nisur nga

⁶⁶Shkresë e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 20.10.2021.

vendndodhja, sipërfaqja e apartamentit dhe çmimi i blerjes nga qiradhënësit për apartamentin me sip. 103 m², në zonën e Tiranës së Re për të cilin ishte paguar, është një çmim pa një logjike ekonomike, duke mbajtur në konsideratë edhe se vlera e cila ishte paguar për këtë apartament ishte ajo prej 92.700 euro; (v) fakti se edhe në nënshkrimin e kontratës së qirasë në vitin 2018 midis palëve, shtetasit A. P. dhe djalit të subjektit, nuk janë specifikuar modalitetet e marrjes së qirasë së këtij apartamenti, koha dhe mënyra e pagesës për këtë marrëdhënie të pretenduar qiraje; si dhe (vi) duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se porositësi i apartamentit nuk ka kryer as regjistrimin e pasurisë, pavarësisht se kanë kaluar mbi 10 vjet nga porositja e apartamentit, të krijojnë bindjen se shtetasi A. P. nuk është pronari *de facto* i këtij apartamenti.

7.2 Lidhur me apartamentet në lagjen “*”, Vlorë**

7.2.1 Në lidhje me banesën në lagjen “***”, rruga “M. T.” Vlorë, subjekti ka deklaruar: *“Kjo është adresa e vendqëndrimit aktual në ditët e punës, apartamenti i marrë me qira është në pronësi të një shtetasi nga Vlora me emër Q. P., emigrant në Itali, për të cilin nuk kam kontratë të formalizuar”*.

7.2.2 Në deklaratimet periodike vjetore të vitit 2013, subjekti ka deklaruar vendqëndrimin tjetër në adresën: Tirana e Re, ish-stacioni i fundit, rruga “I. D.”, p.***, ap. ***, shk. ***, Tiranë. Në DPV-në e vitit 2014, përveç adresës së plotë në fshatin A.P., Gjirokastër, nuk deklarohet vendqëndrim tjetër. Në DPV-në e vitit 2015 nuk deklarohet as adresë të plotë të regjistrimit në gjendje civile dhe as vendqëndrim tjetër. Në DPV-në e vitit 2016 subjekti, në vendqëndrim tjetër, përveç adresës së plotë të regjistrimit në gjendje civile në fshatin A. P., deklarohet adresën: lagjia “***”, rruga “M. T.”, Vlorë.

7.2.3 Në deklaratën *Vetting*, subjekti, në vendqëndrime të tjera, ka deklaruar adresat: *1. Për ditët e punës, lagjia “***”, rruga “M. T.”, P.***, hyrja ***, k. *** (përballë bar-kafe “***”), Vlorë. 2. Për ditët e pushimit, lagjia “***”, rruga “***”, p.***, hyrja ***, k. ***, Tiranë.*

Nisur nga faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit dhe shqyrtimit të kësaj çështjeje, provohet se: (i) ekziston marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me apartamentet në Vlorë, për shkak të përdorimit ndër vite të tyre prej subjektit; (ii) nuk provohet marrëdhënia e subjektit me porositësit e këtyre apartamenteve; (iii) fakti që prej subjektit të rivlerësimit nuk deklarohet në deklaratimet periodike të tij këto marrëdhënie me këto apartamente; si dhe (vi) duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se nuk është kryer as regjistrimi i këtyre pasurive nga porositësit e këtyre apartamenteve, të cilat ndodhen në të njëjtën godinë në Vlorë, nuk të krijojnë bindjen se kush është pronari *de facto* i tyre.

Në lidhje me adresat e banimit të subjektit në rrethin e Vlorës dhe të Tiranës

7.3 Komisioni, për sa i përket pasurive në përdorim nga subjekti në rrethin e Vlorës dhe të Tiranës, vlerëson se subjekti ka kryer transaksione përdorimi për pasuri me vlera të konsiderueshme dhe se shpjegimet e tij lidhur me përdorimin e këtyre banesave nuk janë bindëse, duke krijuar dyshime se duket se këto marrëdhënie huapërdorjeje janë kryer nga subjekti vetëm për arsye se e ka pasur të pamundur për të justifikuar me të ardhura blerjen e pasurive.

7.4 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit, për sa duket se: (i) apartamenti në rrugën “***”, Tiranë; dhe (ii) apartamenti në lagjen “***”, Vlorë, janë pasuri të fshehura të tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

7.5 Në prapësimet e tij, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: “Në analizë të deklaramëve të mia, rezultojnë në mënyrë të saktë adresat e dhëna për vendbanimin dhe për adresat e përdorura nga ana ime. Në lidhje me konstatimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmendur adresat e përdorimit në DPV-të e viteve 2014-2016, sqaroj se formulari i deklaramit nuk kishte ndonjë kërkesë apo rubrikë të posaçme për deklaramin e adresave të përdorimit. Me kërkesën e deklaramës Vetting, adresat e përdorura u kërkuan dhe unë kam dhënë shpjegime të plota për adresën e banimit edhe sipas gjendjes civile, për adresat që kam përdorur në Vlorë për shkak të punës, edhe për adresën e vendbanimit të dy fëmijëve të mi në Tiranë, si adresë e përdorur prej meje, në rastin kur kam shkuar tek fëmijët e mi, dhe në vazhdimësi e njëjta adresë kaloi si adresë e vendbanimit të familjes së djalit tim L. B.. Në lidhje me mosdeklaramin e marrëdhënies së qirasë me këtë banesë në vitet 2014 - 2016, ju sqaroj se vlera e kësaj marrëdhënieje nuk kalonte vlerën e shpenzimeve të deklarameshme mbi 300.000 lekë dhe për këtë shkak nuk e kam përfshirë në DPV. Në deklaramën Vetting e kam deklaruar me vërtetësi këtë marrëdhënie. Në lidhje me konstatimin për ndryshimet në adresën e deklaruar të këtij apartamenti: Ju sqaroj se nuk kemi të bëjmë me një adresë tjetër në aktet e pronësisë së qiradhënësit B. P., të realizuara në vitin 2011, adresa e apartamentit është rruga /lagjja “****”, adresa e deklaruar prej meje është Tirana e Te, ish-stacioni i fundit, rruga “****”, p. ****, ap. ****, shk. ****, Tiranë, nuk është bazuar në ndonjë akt pronësie, por nga identifikimi im, i cili është bazuar në emërtimet e reja dhe unë i jam referuar tabelës dhe faktit që në zonë ky pallat njihej me emrin ****, me qëllim që të jap një deklaram të saktë. Në lidhje me vlerësimet për kohëzgjatjen e kësaj marrëdhënieje, nga ana e Komisionit janë mbajtur dy qëndrime. Në një qëndrim është vlerësuar marrëdhënia e qirasë për periudhën 2013 e në vazhdim dhe ky qëndrim është përdorur në favor të dyshimeve të ngritura. Në një qëndrim tjetër, se nuk provohet marrëdhënia e qirasë për periudhën 2013 - 2018. Fakti është që marrëdhënia e qirasë si veprim juridik nuk kërkon formalizimin e kontratës. Ky apartament u mor me qira në komunikimet me prindërit e moshuar të pronarit B. P., të cilët, pasi komunikuan me djalin e tyre, lejuan vajzën dhe djalin tim për të banuar në këtë banesë, pa e formalizuar me kontratë. Qiraja paguhet rregullisht pranë prindërve të pronarit të apartamentit të cilët jetojnë në të njëjtën lagje. Në lidhje me dyshimet e ngritura për kohëzgjatjen e marrëdhënies së qirasë së këtij apartamenti dhe për vlerën e ulët të saj, ju sqaroj se: qiramarrësit para fëmijëve të mi kishin dëmtuar shtëpinë e pronarit, si dhe nuk kishin paguar qiranë për disa muaj. Në këto kushte, prindërit e qiradhënësit kishin pranuar ta jepnin shtëpinë me qira më të vogël, por në njerëz të besuar, të sigurt që do kryenin pagesat dhe do e mirëmbanin apartamentin. Pavarësisht se kjo zonë sot quhet e preferuar dhe me çmime të larta, në kohën e marrëveshjes ishte zonë e parregulluar me rrugë të vjetra, me shumë pluhur dhe pa sistemuar, me çmime të ulta. Pavarësisht së apartamenti ndodhet në një pallat të ri, pozicionin i tij në rrugë me zhurmë dhe pluhur është i pa preferuar për tregun e qirasë, për këtë arsye qiraja është e ulët. Në lidhje me dyshimet e ngritura se kjo banesë nuk është në pronësi të qiradhënësit B. P., ju sqaroj se pasuria është porositur, blerë dhe regjistruar nga pronari B. P.. Nga ana e noterës ju janë vënë në dispozicion kontrata e porosisë e lidhur midis B. P. dhe shoqërisë “****”sh.p.k., datë 23.12.2009. Me pas është regjistruar prona sipas vërtetimit hipotekor nr.****, datë 19.12.2011, ju paraqes aktin e regjistrimit. Fakti që ky shtetas jeton në Greqi nuk mund të përdoret si arsye se nuk provohet bindshëm marrëdhënia e porositësit të këtij apartamenti me këtë apartament, përkundrazi, ky person disponon të ardhura për të blerë një apartament në vendin e banimit të tij në Tiranë dhe t’ia u lerë prindërve për administrimin e qirasë dhe përdorimin e saj. Unë dhe familja ime nuk kemi njohje dhe lidhje me personin B. P., nuk e kemi takuar, përveç lidhjes së kontratës së qirasë me djalin L. B., me lidhjen dhe njoftimin e nënës së tij. Në lidhje me dyshimet e ngritura për apartamentin që përdor aktualisht në Vlorë, se nuk është në pronësi të qiradhënësit Q. P., për shkak se nuk është regjistruar në emër të tij në ZVRPP-në Vlorë,

por ekziston mundësia e transaksioneve të përdorimit nga ana ime, ju sqaroj se apartamenti i qiradhënësit Q. P. është i regjistruar në ZVRPP-në Vlorë në emër të bashkëshortes E. P., po ju paraqes kopje të certifikatës së pronësisë dhe certifikatës familjare, me të cilat vërtetohet ky fakt. Nuk e kam deklaruar në deklaratimet periodike, për shkak se vlera e qirasë e paguar për këto apartamente ka qenë e vogël dhe shumë më e ulët se shpenzimet e deklarueshme. Në deklaratën Vetting e kam deklaruar nga viti 2012 e aktualisht. Nuk kam pasur asnjë lidhje apo njohje me pronarët e apartamenteve të përdorura nga ana ime nga viti 2012 - 2018, apartamentet i kam marrë më qira tek të afërmit e tyre dhe nuk kam pasur ndonjë konflikt interesi për shkak të marrjes me qira të apartamenteve. Vlera e ulët e qirasë lidhet me faktin se këto apartamente i kam përdorur vetëm 4 ditë në javë, që do të thotë gjysma e kohës së muajit. Në konkluzion, në këto rrethana fakti, nuk ekziston asnjë mundësi për kryerjen e transaksioneve të dyshimta nga ana ime me këta persona”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

7.6 Trupi gjykues, pasi administroi provat që rezultuan gjatë hetimit, deklaratimet e subjektit në pyetësorë, si dhe provat dhe prapësimet e tij pas kalimit të barrës së provës, analizon se subjekti nuk ka qenë koherent në deklaratimet e tij në DPV në lidhje me përdorimin e apartamentit në lagjen “****”, Vlorë dhe apartamentin në rrugën “****”, Tiranë. Komisioni, në bazë të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016⁶⁷, konstatoi mosdeklarime të subjektit në deklaratat periodike të disa viteve.

7.7 Sa i takon provave të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës në lidhje me apartamentin e banimit në rrugën “****”, fotokopje të vërtetimit të pronësisë në emër të shtetasit B. P., Komisioni vlerësoi se kjo provë nuk është në formën e kërkuar nga ligji (e pa vërtetuar nga noteri); i përket vitit 2011 dhe nuk është i shoqëruar me dokumentacion të rifreskuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

7.8 Lidhur me apartamentin pranë lagjes “****”, Vlorë, për të cilin subjekti ka paraqitur një fotokopje të certifikatës së pronësisë, jo në formën e kërkuar nga ligji (e pa noterizuar) në të cilën nuk deklarohet emri i pronarit të apartamentit, vendi ku ndodhet prona dhe detaje të tjera të saj, subjekti në këtë proces ka barrën e provës të vërtetoje të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues, si librezat të furnizimit me energji elektrike dhe librezat të furnizimit me ujë, pronësinë e këtyre apartamenteve.

7.9 Komisioni, analizoi të dhënat që rezultuan nga hetimi në lidhje me apartamentin në Tiranë, si kohëzgjatja e marrëdhënies së përdorimit të kësaj pasurie nga subjekti nga viti 2012 e aktualisht, vlera e qirasë prej 18.000 lekësh/muaj e një apartamenti të tillë që presupozohet të ketë një vlerë shumë të madhe në treg, konsideruar pozicionin, sipërfaqen dhe mobilimin e tij.

7.10 Në vlerësimin e Komisionit mbështetur edhe në jurisprudencën e Kolegjit⁶⁸, këto fakte tregojnë më shumë për një marrëdhënie të konsoliduar dhe të sigurt të subjektit të rivlerësimit me këtë pronë, që del jashtë kufijve normalë të logjikës ekonomike dhe juridike të shfrytëzimit të një marrëdhënieje qiraje. Gëzimi i gjithë fryteve të një pasurie në raport të shproporcionuar me atë që duhet të ofrojë vetë marrëdhënia ligjore në bazë të së cilës mbahet sendi, të krijojnë mosbesim mbi vetë natyrën e marrëdhënies së qirasë.

7.11 Në lidhje me apartamentin në lagjen “****”, Vlorë, pretendimi i subjektit se qiraja është e ulët për shkak se përdoret vetëm 4 ditë në javë, pothuajse gjysmë muaji, është një argument jo bindës, jashtë realitetit dhe qëllimit për të cilin jepet me qira sendi dhe që shkon në dëm të

⁶⁷Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë në ILDKPKI, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji.

⁶⁸Vendim nr. 26/2019 (JR), i Kolegjit të Posacëm të Apelimit .

interesave të pronarit. Gëzimi dhe përdorimi i tyre jo prej pronarëve të pretenduar, por prej subjektit në një raport të zhdrejtë për sa i përket asaj që subjekti ofron në këmbim të këtyre privilegjeve, janë rrethana që tregojnë dhe demonstrojnë sjelljen si pronar të subjektit të rivlerësimit mbi këto pasuri.

7.12 Në përfundim të analizës, Komisioni çmon se lidhur me pasuritë apartament banimi në rrugën “****”, Tiranë, dhe apartament banimi në lagjen “****”, Vlorë, subjekti gjendet në lidhje me këto pasuri në situatën e parashikuar nga pika 5 e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe gjermës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

8. Analiza e treguesve financiarë

8.1 Bazuar në dokumentacionin e administruar, si dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për periudhën 2003 – 2016, nga e cila duket se subjekti, me përjashtim të viteve 2004, 2005, 2006 dhe 2010, për të gjithë vitet e tjera⁶⁹ ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme të të ardhurave për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara.

8.2 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

8.3 Subjekti i rivlerësimit, përveç sa parashtruar në qëndrimin e tij pas rezultateve të hetimit për pasuritë nr. 3 dhe 4 në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet minimale për konsum, në analizën e kryer:

- Për vitet 2007, 2008 dhe 2009, ndër të tjera, ka kërkuar: pasqyrimin e vlerës së pagës *neto* (për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2007), në bazë të të dhënave nga llogaria e pagës në “Raiffeisen Bank”; pasqyrimin e të dhënave nga INSTAT-i për të ardhurat e përfituara nga sektori bujqësor (familjet që banojnë në fshat), në vlerën 19.265 lekë/ muaj; aplikim të shpenzimeve mesatare mujore për jetesë për konsum ushqimor, jo ushqimor, edukim dhe blerje pajisjesh afatgjata për një person për zonat malore për vitin 2008, në vlerë 7.175 lekë/muaj.

- Për vitet 2011, 2012 dhe 2013, ndër të tjera, parashtron se: “...gjendja *cash e mbetur në fund të vitit 2011 është 2.200.000 lekë, e cila përbëhet nga gjendja në fillim të vitit prej 1.200.000 lekësh dhe shtesa e kursimeve cash gjatë vitit 2011 në vlerën 1.000.000 lekë; gjendja cash e mbetur në fund të vitit 2013 është 2.400.000 lekë...*”.

- Për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ndër të tjera, parashtron se: “...në lidhje me shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit, kemi qëndruar në familjarët tanë, siç e kemi deklaruar... kemi qëndruar gjithnjë në banesat e të afërmeve tanë; nuk është marrë parasysh lëvizja e gjendjes *cash për çdo vit, shtesat dhe pakësimet e tij, nga gjendja cash e akumuluar gjatë viteve në vitin 2016 nga kjo shumë është bërë depozitimi i tij në depozitë bankare në shumën 3.800.000 lekë ...*”.

Subjekti ka bashkëlidhur edhe një pasqyrë të analizës financiare të tij dhe të personave të lidhur, për periudhën 2003 – 2016, në të cilën vetëm viti 2014 ka rezultuar me balancë negative në shumën 298.087 lekë, si dhe raportin e datës 2.12.2021, të audituesit ligjor të kontraktuar prej tij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

⁶⁹Një pjesë janë pasqyruar edhe më lart në analizë të pasurive nr. 3 dhe 4.

8.4 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar, shpjegimet, provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe në deklaratimet në seancat dëgjimore të zhvilluara me subjektin e rivlerësimit, arsyeton se:

8.5 Analiza e treguesve financiarë për periudhën 2003 – 2016 (dhe jo vetëm) është kryer për të verifikuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga këto burime, duke u mbështetur në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar nga Komisioni, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

8.6 Në analizë të pasurive nr. 3 dhe nr. 4, pjesë të këtij vendimi, Komisioni ka analizuar burimet e deklaruara të të ardhurave, si dhe mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur për krijimin e këtyre pasurive. Në këtë analizë është përfshirë, ndër të tjera, edhe qëndrimi dhe arsyetimi ligjor i Komisionit në lidhje me një pjesë të të ardhurave të pretenduara nga subjekti, për t'u përfshirë në analizën e treguesve financiarë, si dhe në lidhje me shpenzimet minimale për konsum.

8.7 Për sa i përket të ardhurave nga paga e subjektit, Komisioni ka pasqyruar të dhënat e përcjella nga institucionet shtetërore përkatëse, konkretisht, në bazë të vërtetimit nr. ***prot., datë 14.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe vërtetimit nr. *** prot., datë 19.1.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Referuar dokumentacionit sa më sipër, të ardhurat *neto* nga paga e subjektit të rivlerësimit për vitin 2007 rezultojnë në vlerën 1.053.276 lekë. Komisioni, në shqyrtim të pretendimit të subjektit dhe të dhënave nga “Raiffeisen Bank”, pasqyroi në analizë vlerën prej 1.180.442 lekësh si të ardhura *neto* të kaluara në llogarinë e pagës së subjektit, për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2007⁷⁰.

8.8 Në lidhje me gjendjet *cash* të deklaruara për vitet 2011, 2012 dhe 2013, në analizën e treguesve financiarë nga Komisioni, siç është evidentuar edhe më sipër, kursimet *cash* në banesë janë pasqyruar referuar deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur, përcaktimeve në legjislacionin përkatës⁷¹ dhe jurisprudencës së Kolegjit, duke analizuar dokumentacionin ligjor justifikues të burimit të deklaruar, mundësinë financiare për krijimin, si dhe destinacionin e tyre.

8.9 Ndërsa, për sa i përket shpenzimeve të transportit dhe qëndrimit jashtë vendit, nga Komisioni janë pasqyruar/llogaritur mbi bazë të dokumentacionit ligjor të disponuar, deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe referuar metodologjisë së aplikuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

8.10 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e disponuar si dhe jurisprudencën e Kolegjit (vendim nr. 11, datë 22.5.2019), vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë që shpenzimet e qëndrimit për të dhe/ose personat e lidhur me të janë mbuluar nga persona të tretë.

8.11 Në një vlerësim të dokumentacionit të disponuar dhe analizës sa më sipër, Komisioni vlerëson se me përjashtim të vitit të mbyllur 2007, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit për pamjaftueshmërinë financiare dërguar me rezultatet e hetimit administrativ.

⁷⁰Pas reflektimit të këtyre ndryshimeve, viti 2007, nga një balancë negative në vlerë 101.823 lekë, kalon në balancë pozitive në vlerën 25.343 lekë.

⁷¹Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), si institucion kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin e figurës, ka paraqitur pranë Komisionit raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, ku mungonte informacioni nga një prej tre autoriteteve verifikuese, konkretisht Shërbimit Informativ të Shtetit. Në këtë raport është konstatuar se:

- *Subjekti i rivlerësimit Arqile Llambi Basho ka pasaktësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin të figurës, duke mos deklaruar procedimin penal të regjistruar në ngarkim të tij për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.*

*Konkretisht, rezulton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2015, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky procedim është transferuar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.*

*Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr.***, të vitit 2015, për veprat penale “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal. Ky procedim është pushuar me vendimin e datës 10.12.2015.*

Sa më sipër, bazuar në informacionet konfidenciale apo informacione të tjera për subjektin e rivlerësimit Arqile Llambi Basho, gjykojmë se:

- *Mosdeklarimi nga ana e subjektit të rivlerësimit për procedimin penal që ka pasur në ngarkim të tij, e ngarkon me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti, e plotësimin të pasaktë dhe me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës.*

- *Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit apo pastërtisë së figurës së një funksionari publik, në rastin tonë për Arqile Llambi Basho, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerjen ose moskryerjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jo materiale të padrejta për vetë atë si funksionar publik apo persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit apo personave të tjerë, cenojnë figurën e tij, shkallën e besueshmërisë dhe e bëjnë këtë individ të mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale, sipas përcaktimit të germës “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016.*

Në përfundim, Grupi i Punës konstaton: papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Arqile Llambi Basho.

Bazuar në pikat 2 dhe 4, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se:

- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e detajuar për figurën, duke mos deklaruar procedimin penal nr. 990/2015 në ngarkim të tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në shpjegimet e tij pas kalimit të barrës së provës, subjekti, ndër të tjera ka sqaruar se: “Konkluzioni i DSIK-së është mbështetur vetëm në relacionet e SHÇBA Vlorë, e cila është në konflikt interesi me punën time si gjyqtar në Gjykatën e Vlorës, për këto arsye: (i) në

vlerësimin tim nëse do të bëhej një analizë e thellë fenomeneve që kanë ndodhur me gjykatën do të gjejmë shumë raste të konfliktit të drejtuesve të këtyre strukturave me gjykatën dhe personalisht me vendimet e mia. Në 7-8 vitet e fundit policia është angazhuar në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike në rrethin e Vlorës. Në këtë luftë kanë qenë edhe agjencitë e tjera shtetërore të angazhuara me sigurimin e informacionit. Policia vepronte mbi bazën e këtyre informacioneve dhe në shumë raste nuk kapte autorët e vërtetë të aktivitetit kriminal por punëtorë të angazhuar në vjeljen dhe përpunimin e lëndës narkotike. Ngjarjet kriminale reklamoheshin si suksese në media dhe këto ngjarje mbeteshin pa autorë, policia arrestonte shtetas të pambrojtur, shtetas të komunitetit 'rom'. Në këto rrethana 'presioni' për të konkluduar zbulimin e autorëve kalonte në gjykata dhe vëmendja e drejtuesve të strukturave të policisë ishte tek vendimmarrja e gjyqtareve të cilët mund të zhbënin 'suksesin' e reklamuar të policisë. Në vendimmarrjen time nuk kam lejuar kurrë që të cenohej pa shkaqe liria e shtetasve dhe kam qenë i vëmendshëm ndaj shtetasve të pambrojtur, në kushtet e mungesës së 'dyshimit të bazuar në prova'. Duke urdhëruar lirimin e këtyre personave të arrestuar nga policia si autorë të kultivimit dhe të trafikut të lëndëve narkotike, që në fazën e parë të arrestimit, ka lindur konflikti me drejtues të strukturave të policisë. Procedimi penal ndaj meje ka nisur me ndikimin e drejtuesve të policisë Vlorë që në bashkëpunim me ish-kryetarin e Gjykatës Vlorë, që vazhdoi me kallëzim penal dhe kallëzim disiplinor. Me Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë kam pasur marrëdhënie të shkëlqyera dhe ishte ndërhyrja e tyre që ka sqaruar institucionet e larta shtetërore të mos arrestohesha. Mund t'ju përmend edhe raste të tjera kur puna ime është në konflikt të plotë interesi me punën e ish-drejtuesve të Policisë Vlorë; (ii) kam deklaruar procedimin penal nuk e kam mohuar në deklaratimet e mia ekzistencën e procedimeve penale, kam deklaruar se për shkak të natyrës së punës kam pasur procedime penale të cilat kanë përfunduar me 'mosfillim' apo 'pushim' dhe nuk ka ndonjë procedim penal që të ketë sjellë pasoja juridike për mua. Në lidhje me këtë procedim janë kryer dy kallëzime: kallëzim penal në prokurori dhe kallëzim disiplinor në KLD nga ish-Kryetari i Gjykatës. I pari ka përfunduar me 'pushimin e procedimit penal' dhe i dyti me 'vërejtje konfidenciale'.

Në lidhje me rrethanat e procedimit, mund t'ju them se vendimi i pushimit të procedimit nga prokuroria dhe vendimi i vërejtjes nga KLD-ja janë vendime të formës së prerë dhe përbëjnë 'gjënë e gjykuar'. Sa i takon rrethanave të faktit, kam pasur çështjen në shqyrtim dhe seanca është shtyrë për konkluzionet përfundimtare të prokurorit dhe mbrojtjes. Mbi rrethanat e shqyrtuara për efekt ekonomie gjyqësore, përgatita një vendim të arsyetuar për deklarimin e pafajshëm të të pandehurit, për të pasur të gatshëm në seancën e të nesërme, si dhe të mos krijoja stok në dosjet për arsyetim. Në konkluzione, prokurori parashtroi rrethana dhe analizë tjetër, ndryshova mendim dhe formulova me shkrim vendimin sipas kërkesave të prokurorit për dënimin e të pandehurit me 20 ditë burgim dhe pezullim të këtij dënimi, duke e vënë të pandehurin në provë. Pas kësaj numërojt vendimin e dhënë në kryesekretari, dispozitiv i shkurtuar dhe i regjistruar audio. Sekretarja gjyqësore (punonte me mua në të njëjtin kompjuter) gjen vendimin në kompjuter, heq vendimin ollograf të dispozitivit, e qep dosjen me vendimin që kishte gjetur në kompjuter dhe ma paraqet se bashku me 7-8 dosje të tjera për firmë. Në kushtet e ngarkesës së punës unë kam firmosur dosjen së bashku me të tjerat, pa e vënë re me besimin te sekretarja gjyqësore. Sapo u informova se çfarë kishte ndodhur u investova të tërhiqja dosjen dhe vendimin, por nuk më lejoi kryesekretarja, atëherë bëra kërkesë për ndreqje të gabimit material dhe thirra palët në gjykim. U vendos korrigjimi i gabimeve, duke u saktësuar sipas vendimit të shpallur. Ndërkohë, ish-Kryetari i Gjykatës bëri kallëzim në prokurori dhe kallëzim disiplinor në KLD. Në lidhje me procedimin penal nr. ***/2015 kam dhënë shpjegimet e mia pranë prokurorit të çështjes. Kam përballuar me përkushtim një ngarkesë pune, duke dhënë 700 deri 900 vendime në vit, ndërkohë që norma ka qenë 150-200 vendime në vit. Kam qëndruar larg politikës dhe larg lidhjeve

kriminale. Si konkluzion, rezultati i DSIK-së për figurën është bazuar në relacione që përbëjnë konflikt interesi dhe nuk mund të përdoren për të konkluduar mbi figurën time”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Nga hetimi ka rezultuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka dërguar për gjykim shtetasin E. M., i akuzuar për veprën penale “vjedhje të energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, sipas paragrafit të parë të parashikuar nga neni 137 i Kodit Penal. Organi procedues përfaqësohej në gjykim nga prokurori A. Z. Gjatë zhvillimit të gjykimit shtetasi E. M. në deklarinimin në seancë ka kërkuar që të përfaqësohej nga mbrojtësja e zgjedhur prej tij, av. E. H.. Në kuadër të këtij procedimi, në datën 8.1.2015 është sekuestruar dosja gjyqësore në ngarkim të shtetasit E. M., gjykimi ndaj të cilit ka përfunduar më dhënien e vendimit penal nr. ***, datë 29.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së dosjes gjyqësore të sekuestruar rezulton se në datën 21.5.2015 gjyqtari i çështjes Arqile Basho, pasi ka administruar edhe konkluzionet e palës mbrojtëse, nuk e ka shpallur vendimin gjyqësor po atë ditë, por e ka shtyrë shpalljen e vendimit për në datën 29.5.2015. Në datën 29.5.2015, gjyqtari Arqile Basho në mungesë të të pandehurit dhe të mbrojtësit të zgjedhur prej tij, në prani vetëm të prokurorit ka shpallur vendimin gjyqësor në ngarkim të të pandehurit E. M. i akuzuar se ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, ku ka vendosur: 1. “Deklarimin fajtor të të pandehurit E. M. për veprën penale ‘vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike’ parashikuar nga neni 137/1, 48/ç dhe 49 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me një muaj burgim. 2. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale urdhërohet 1/3 e uljes së dënimit në ekzekutim të këtij vendimi. 3. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe të dhënë në këtë vendim duke e vënë të pandehurin në provë për një afat prej 18 muajsh. 4. Urdhërohet i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës Vlorë për ndryshimin e banimit apo për lëvizjet brenda vendit. 5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 10 ditëve duke filluar nga e nesërmja e shpalljes. Procesverbali i seancës gjyqësore është i nënshkruar nga gjyqtari i çështjes Arqile Basho dhe sekretare gjyqësore R. L.”.

- Në datën 7.7.2015, sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë i ka dërguar vendimin nr. ***, datë 29.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se në dispozitivin e tij është vendosur: “1. Deklarimin të pafajshëm të të pandehurit E. M. për kryerjen e veprës penale të ‘vjedhjes së energjisë elektrike ose impulsive telefonike të parashikuara nga neni 137/1 i Kodit Penal. 2. Shpenzimet e hetimit dhe ato gjyqësore i ngarkohen prokurorisë. 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 10 ditëve duke filluar nga e nesërmja e shpalljes. Për të pandehurin në mungesë afati fillon nga dita e komunikimit të këtij vendimi. U shpall në Vlorë, më 29.5.2015. Ky vendim është nënshkruar nga gjyqtari i çështjes Arqile Basho dhe sekretare gjyqësore R. L.”.

- Rezulton se në datë 8.7.2015, gjyqtari i çështjes Arqile Basho kryesisht ka depozituar një kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt ndreqje gabimi material të vendimit penal nr. ***, datë 29.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pasi ka njoftuar palët, të pandehurin dhe mbrojtësin, prokurorin e çështjes A. Z. është zhvilluar seanca gjyqësore, gjyqtari Arqile Basho ka vendosur ndreqjen e gabimit material të vendimit nr. *** datë 29.5.2015, duke ndryshuar pjesën arsyetuese të këtij vendimi dhe pjesën e dispozitivit të tij të shpallur në seancë gjyqësore më 29.5.2015.

- Nga studimi i mëtejshëm i përmbajtjes së vendimit penal nr. ***, datë 29.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se nga faqja 3 – 6, të këtij vendimi, gjyqtari i

çështjes ka bërë një arsyetim të fakteve dhe të provave të marra për shqyrtim, të cilat nuk krijojnë bindjen përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri E. M. është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe, si rrjedhim, ka vendosur në dispozitiv deklarimin e pafajshëm të të pandehurit E. M..

- Në vijim të hetimeve, pasi është administruar dosja gjyqësore dhe janë dërguar aktet e dërguara për kompetence është regjistruar procedimi penal nr. ***/2015, në kuadër të të cilit janë kryer disa veprime të tjera hetimore. Janë pyetur në cilësinë e personit që kanë dijeni për veprën penale shtetasit: A. Z. (prokuror), E. H. (avokate), E. M. (i pandehur), E. B. (sekretare gjyqësore), R. L. (sekretare gjyqësore), M. B. (ish-sekretare gjyqësore), S. H. (kryetar i Gjykatës), R. T. (kancelare e gjykatës), A. J. (mjek imazherist), M. B. (Mjek imazherist) dhe D. D. (mjek neurolog). Është pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet shtetasi Arqile Basho (gjyqtar), si dhe i është kërkuar informacion për administrim të informacionit shkrësor disa institucioneve shtetërore.

- Në lidhje me çështjen me datë 29.07.2015 është pyetur në cilësinë e personit nën hetim shtetasi Arqile Basho, me detyrë gjyqtar, i cili ka deklaruar se është caktuar me short për të gjykuar çështjen penale në ngarkim të shtetasit E. M., i cili është mbrojtur në gjykim nga av. E. H. Bazuar në kërkesën e të pandehurit dhe të mbrojtësit të tij, si dhe me pëlqimin e mbrojtësit të akuzës prokurorit A. Z., për zhvillimin e këtij gjykimi, sipas rregullave të gjykimit të posaçëm, deklaroi se në datën 7.5.2015 janë paraqitur konkluzionet përfundimtare të përfaqësuesit të organit të akuzës, i cili ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit dënimin me një muaj burgim dhe pas aplikimit të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar të të pandehurit E. M. me 20 ditë burgim. Ai deklaroi se me datë 7.05.2015 ka pasur problem shëndetësor dhe në datën 8.07.2015 ka bërë disa analiza mjekësore. Në datën 11.05.2015 është pajisur me raport 4-ditor dhe në datën 20.05.2015 ka vijuar procesi me konkluzionet përfundimtare të mbrojtjes, e cila ka kërkuar deklarimin të pafajshëm për të pandehurin E. M. dhe aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 59 të Kodit Penal. Në datën 29.05.2015, gjyqtari deklaroi se ka pasur një kalendar të ngjeshur dhe është asistuar nga sekretare të ndryshme. Në seancën e shpalljes së vendimit të të pandehurit E.M. ka qenë prezent prokurori. Gjykata e ka deklaruar fajtor dhe aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal. Pas disa gjykime të tjera të zhvilluara është paraqitur avokati mbrojtës i të pandehurit, i cili ka marrë dijeni për vendimin.

Shtetasi Arqile Basho ka deklaruar se në datën 8.07.2015 rreth orës 10-11 është paraqitur kancelaria e gjykatës shtetasja R. T., e cila i ka deklaruar se ka një mospërputhje midis vendimit që është shpallur në seancë gjyqësore dhe dispozitivit të vendimit të arsyetuar. Pasi ka marrë dijeni për këtë fakt, ka marrë dosjen dhe e ka konstatuar se kishte një ndryshim midis vendimit të shpallur në seancë dhe vendimit gjyqësor të zbardhur. Më pas, ka njoftuar palët për të riparuar këtë gabim që ka ndodhur për shkak të ngarkesës në punë dhe problemeve shëndetësore, duke e zëvendësuar këtë vendim sipas vendimit të shpallur në seancë, por kancelaria ka refuzuar me argumentimin se ky vendim i ishte njoftuar të pandehurit. Shtetasi Arqile Basho pas refuzimit të kancelares R. T. për të zëvendësuar vendimin ka paraqitur kërkesë në gjykatë për ndreqje gabimi material të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 29.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke njoftuar palët. Gjatë zhvillimit të gjykimit ju ka bërë me dije palëve gabimin material të vendimit nr. ***, datë 29.5.2015 dhe me vendimin nr. ***, datë 8.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur korrigjimin e gabimit material të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 29.5.2015, sipas vendimit gjyqësor të shpallur në seancën e datës 29.5.2015 dhe procesverbalit të seancës gjyqësore.

I pyetur, në lidhje me faktin se vendimi nr. ***, datë 29.5.2015, kishte marrë formë të prerë në datën 8.07.2015, shtetasi Arqile Basho deklaroi se në këtë moment ai nuk e dinte nga komunikimi me shtetasen R. T. nuk i ka deklaruar se ky vendim ka marrë formë të prerë. Por edhe nëse ky vendim kishte marrë formë të prerë me datë 8.7.2015, ligji nuk e pengon gjykatën që të procedojë me korrigjimin e vendimit gjyqësor. I pyetur, në lidhje me faktin se përse vendimi gjyqësor nr. ***, datë 29.5.2015, është i ndryshëm me vendimin gjyqësor të shpallur në seancë, shtetasi Arqile Basho përgjigjet se kjo ka ardhur për shkak të mbingarkesës së padrejtë nga kryetari i gjykatës me dosje gjyqësore, të problemeve të ndryshme shëndetësore që po kalonte atë periudhë, ku me rekomandimin e mjekut neurolog është trajtuar me medikamente të ndryshme dhe se për arsye se kishte punuar me sekretare të ndryshme. Në përfundim, shtetasi Arqile Basho, ka kërkuar të administrohen në cilësinë e provës disa imazhe imazherike dhe të sqarohen nga mjeket përkatës neurologe. Gjithashtu, është paraqitur raporti mjekësor i mjekut të familjes i Spitalit Rajonal Gjirokastër, si dhe disa shkresa lidhur me vlerësimin në punë nga KLD-ja, kopje e kalendarit të caktimit të seancave gjyqësore, si dhe dokumente të tjera shkresore, të cilat janë administruar nga organi procedues.

Organi procedues ka vijuar hetimet duke pyetur avokatin e çështjes, prokurorin, kryetarin e gjykatës, i cili ka hedhur poshtë pretendimet e shtetasit Arqile Basho se ai ka ngarkesë të madhe në punë, pasi ngarkesa është për të gjithë gjyqtaret dhe jo vetëm për shtetasin Arqile Basho.

Është pyetur kancelaria e gjykatës, znj. R. T., e cila ka shpjeguar procedurën e regjistrimit të vendimeve penale në regjistrat e sekretarisë, momentin kur ajo ka parë që kishte mospërputhje midis vendimit të shpallur dhe atij të zbardhur nga gjyqtari Arqile Basho. Ajo ka njoftuar menjëherë kryetarin e gjykatës dhe ka refuzuar të bëjë zëvendësimin e vendimit, pasi kishte njoftuar palën e pandehur për vendimin e pafajësisë. Kancelaria hodhi poshtë edhe pretendimin e gjyqtarit se ai ka punuar me sekretare të ndryshme. Ajo deklaroi se në atë periudhë sekretarja gjyqësore M. D. (B.) ka qenë me raport mjekësor dhe për këtë arsye është caktuar sekretare R. L.. Ngarkesa e gjyqtarit Arqile Basho është si për të gjithë gjyqtarët. Janë pyetur edhe shtetasit e tjerë si sekretare E. B., R. L., M. B., E. M., mjeku radiolog A. J., dr. M. B. etj.

Në datën 20.11.2015 është pyetur mjeku D. D., në cilësinë e personit i cili ka dijeni për veprën penale. Ai deklaroi se ka vizituar pacientin Arqile Basho pas kërkesës për konsultim të dr. M. B. dhe dr. A. J.. Ai deklaroi se mjekët imazheristë kanë konstatuar sindromën “*Subatrofi cerebrale kortikale me evidente në lobet frontale*”, por gjatë intervistimit klinik ai nuk ka konstatuar një klinike apo sëmundje të tillë.

Organi procedues ka kërkuar informacione nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kërkimet e tabulateve pranë telefonisë celulare “****”, nga ku ka rezultuar se shtetasi Arqile Basho ka komunikuar me avokatin e të pandehurit 24 herë, gjatë periudhës 1.1.2015 – 15.7.2015, gjysma e këtyre telefonatave janë bërë më 8.7.2015. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. *** datë ka vendosur:

- Pushimin e procedimit penal nr. ***/2015 për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin dhe “shpërdorim i detyrës”, të parashikuara përkatësisht nga neni 186 paragrafi 3 dhe 248 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit Arqile Basho.

Konkluzioni për kontrollin e figurës

Trupi gjykues i Komisionit, në analizë të provave të mësipërme, vlerëson se bazuar në nenin DH, pika 2, të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit plotësojnë një deklaratë të detajuar për figurën e tyre, që mbulon periudhën nga data 1.1.2012 deri në ditën e deklarimit, sipas ligjit. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal. Nga interpretimi i kësaj dispozite kushtetuese, rrjedh detyrimi i subjektit të rivlerësimit që të tregojë fakte të detajuara në lidhje me figurën e tij, fakte të cilat nuk do të përdreshin si provë në asnjë rast, gjatë një procedimi penal.

Legjislatori me anë të këtij formulimi ka pasur për qëllim të testojë integritetin moral, qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në raport me vërtetësinë e fakteve, ngjarjeve të jetës së tij për një periudhë të caktuar. Mosdeklarimi nga ana e subjektit i procedimit penal nr. ***/2015, pavarësisht se kemi të bëjmë me një procedim penal të pushuar, e ngarkon subjektin me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti dhe të plotësimit të pasaktë dhe të pavërtetë të deklaratës për kontrollin e figurës.

Komisioni, pas hetimit të kryer për këtë kriter, bazuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të raportit të DSIK-së, rezultateve të hetimit lidhur me çështjen e referuar më lart dhe në kuadër të çmuarjes së shpjegimeve që ka dhënë edhe subjekti, konstaton se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut të drejtësia⁷², në zbatim të pikës 2, të nenit 4 dhe të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, provat e administruara, rekomandimin e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, arrin në përfundimin se:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, në referim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim të tij, në referim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- b) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të drejtësia.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç dhe D, DH të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arqile Basho, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁷²Vendimi i GjEDNj-së, Xh. kundër Shqipërisë, 9 shkurt 2021, paragrafi 387: *[Në lidhje me cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, Gjykata vëren se edhe pse kjo bazë për shkarkim nga detyra është formuluar në terma mjaft të gjerë, pasja e një dispozite të tillë në legjislacionin disiplinor dhe rregulloret e disiplinës gjyqësore nuk është e pazakontë. Normalisht kjo dispozitë duhet të lexohet dhe të interpretohet së bashku me rregullat e tjera disiplinore më specifike, në fuqi në atë kohë, duke sanksionuar shkelje të një natyre etike ose profesionale..]*

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 15.12.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Xhensila PINE
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku